



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

RAPORTI I MES-VITIT MBI ZBATIMIN E BUXHETIT 2020

**VLERËSIMI I SITUATËS MAKROEKONOMIKE, FISKALE DHE
BUXHETORE PËR 5-MUJORIN 2020,
DHE PRITSHMËRITË PËR 12-MUJORIN 2020**

Tiranë, Qershor 2020

PËRMBAJTJA

Tabela dhe Grafikë	3
I. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE	5
I.1 Ecuria e treguesve makroekonomikë për periudhën janar-maj 2020	5
I.2 Pritshmëritë e treguesve makroekonomikë deri në fund të vitit 2020	6
II. POLITIKA FISKALE.....	7
II.1 Performanca fiskale për periudhën janar-maj 2020.....	7
II.2 Pritshmëritë fiskale deri në fund të vitit 2020	14
III. BUXHETI I VITIT 2020.....	15
III.1 Shpenzimet e Përgjithshme Buxhetore gjatë periudhës janar-maj 2020	15
III.2 Financat Vendore gjatë janar-maj 2020.....	22
III.3 Fondi Rezervë, Fondi i Kontigjencës, Fondi i Veçantë & Fondi për Rritjen e Pagave....	28
III.4 Pritshmëria e Shpenzimeve Buxhetore deri në fund të vitit 2020	29
IV. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK	31
IV.1 Stoku i Borxhit Publik	32
IV.2 Menaxhimi i Borxhit.....	34
IV.3 Pritshmëritë e Borxhit për vitin 2020	37
V. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE	37
V.1 Sektori Energjetik	39
V.2 Detyrimet e prapambetura (qendrore)	41
V.3 Koncesionet/PPP-të	43
V.4 Detyrime të tjera Kontigjente	45
VI. KONKLUZIONE DHE PROPOZIME	47
VII. SHTOJCAT	49
VI.1 Ecuria e detajuar e treguesve makroekonomikë gjatë janar-maj 2020	49
VI.2 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2020	55
VI.3 Ecuria e detajuar e projekteve të investimeve publike, gjatë Janar-Maj 2020	78

Lista e Tabelave

Tabela 1: Të ardhurat Tatime & Dogana për periudhën Janar – Maj 2020 (në milionë lekë).....	7
Tabela 2: Të dhëna mbi sasitë e mallrave kryesorë të akcizës.....	10
Tabela 3: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga Akciza/Diferencat Janar-Maj 2020/2019.....	11
Tabela 4: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga Akciza/ Diferencat Janar-Maj 2020/2019.....	11
Tabela 5: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga TVSH/Diferencat Janar-Maj 2020/2019.....	11
Tabela 6: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga TVSH/ Diferencat Janar-Maj 2020/2019.....	11
Tabela 7: Të dhëna për Rentën Minerare, naftë bruto dhe minerale të tjera (në mijë lekë).....	12
Tabela 8: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2020 (në milion LEK).....	15
Tabela 9: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2019 dhe 2020 (në milion LEK).....	15
Tabela 10: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës.....	27
Tabela 11: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto&neto (Janar-Mars 2020).....	34
Tabela 12: Huamarrja e huaj në terma bruto (TM. I 2019-TM. I 2020).....	35
Tabela 13: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2018–Maj 2020).....	36
Tabela 14 Matrica e riskut.....	38
Tabela 15: Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë Lekë).....	39
Tabela 16: Detyrimet e prapambetura të njësisve të qeverisjes qendrore deri në Mars 2020.....	41
Tabela 17: Detyrimet e prapambetura të MIE, sipas zërave kryesorë (në milionë Lekë).....	42
Tabela 18: Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë).....	45
Tabela 19: Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR).....	46
Tabela 20: Kritja e eksportit të mallrave, sipas kategorive kryesore.....	50
Tabela 21: Kritja e importit të mallrave, sipas kategorive kryesore.....	51
Tabela 22: Bilanci tregtar, sipas kategorive kryesore.....	52
Tabela 23: Kritja vjetore e çmimeve, në përqindje.....	53
Tabela 24: Ecuria e kredisë për bizneset dhe individët, në përqindje.....	54
Tabela 25: Ecuria e kredive të këqija, në përqindje.....	54
Tabela 26: Ecuria e kursit të këmbimit 2015-2020.....	55
Tabela 27: Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2020.....	55
Tabela 28: Shëndetësia dhe mbrojtja sociale.....	56
Tabela 29: Arsimi.....	58
Tabela 30 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural.....	61
Tabela 31: Infrastruktura dhe Energjia.....	62
Tabela 32: TURIZMI DHE MJEDISI.....	65
Tabela 33: Drejtësia.....	66
Tabela 34: Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.....	67
Tabela 35: Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional.....	68
Tabela 36: Mbrojtja.....	69
Tabela 37: Rendi dhe Siguria Publike.....	73
Tabela 38: Kultura.....	75
Tabela 39: Politika e Jashtme.....	77

Lista e Grafikëve

Grafiku 1: Totali i të ardhurave Janar- Maj 2020/2019 (në milionë lekë).....	8
Grafiku 2: Import i Taksuar dhe Eksport Total 2020/2019(në miliard lekë).....	9
Grafiku 3: Të ardhurat Doganore për Janar- Maj 2020, mujore dhe progresive (në milion lekë).....	9
Grafiku 4: Kontribuesit kryesor në të ardhurat doganore Janar- Maj 2020/2019 (në milion lekë).....	10
Grafiku 5: Të ardhurat nga Tatimet Janar- Maj 2020, Mujore dhe Progresive (në milionë lekë).....	12
Grafiku 6: Të ardhura nga TVSH dhe rimbursimi i TVSH, 5 mujori në vite (në miliardë lekë).....	13
Grafiku 7: Të ardhurat nga Tatim Fitimi, 5 mujori në vite (në miliardë lekë).....	13
Grafiku 8: Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në vite (në milion lekë).....	13
Grafiku 9: Të ardhurat 5 mujore nga Taksat nacionale, në vite (në miliardë lekë).....	14
Grafiku 10: Të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT, në vite (në miliardë lekë).....	14
Grafiku 11: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK).....	16
Grafiku 12: Shpenzimet korente dhe kapitale Plan vs Fakt (në miliard LEK).....	16
Grafiku 13: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme, për periudhën 5 mujore 2020.....	16
Grafiku 14: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK).....	17
Grafiku 15: Struktura e shpenzimeve korente, për periudhën 5 mujore 2020.....	17
Grafiku 16: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK).....	18
Grafiku 17: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK).....	18

<i>Grafiku 18: Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK)</i>	19
<i>Grafiku 19: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)</i>	19
<i>Grafiku 20: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)</i>	19
<i>Grafiku 21: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë LEK)</i>	20
<i>Grafiku 22: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK)</i>	21
<i>Grafiku 23: Shpenzimet për Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)</i>	21
<i>Grafiku 24: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)</i>	21
<i>Grafiku 25: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)</i>	22
<i>Grafiku 26: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficioni/suficioni - Plan vs Fakt 5 Mujori 2019 (në milion LEK)</i>	22
<i>Grafiku 27 Të ardhurat sipas burimit për njësitë vendore</i>	23
<i>Grafiku 28: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor</i>	24
<i>Grafiku 29: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor</i>	24
<i>Grafiku 30: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor</i>	25
<i>Grafiku 31: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor</i>	25
<i>Grafiku 32: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritimi i ndryshimit të tyre</i>	26
<i>Grafiku 33: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës</i>	26
<i>Grafiku 34: Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2016–Mars 2020)</i>	32
<i>Grafiku 35: Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me totalin (2016-Mars 2020)</i>	32
<i>Grafiku 36: Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2016–Mars 2020)</i>	33
<i>Grafiku 37: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror (2016-Mars 2020)</i>	33
<i>Grafiku 38: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit dhe instrumenteve (2016-Mars 2020)</i>	33
<i>Grafiku 39: Huamarrja e brendshme në raport me të ardhurat tatimore (TM. I 2016-TM. I 2020)</i>	34
<i>Grafiku 40: Interesat e borxhit shtetëror në vlerë absolute dhe relative, ndaj PBB dhe të ardhurave tatimore (TM. I 2016-TM. I 2020)</i>	35
<i>Grafiku 41: Jetëgjatësia&kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm shtetëror (2016-Mars 2020)</i>	35
<i>Grafiku 42: Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Mars 2020)</i>	36
<i>Grafiku 43: Norma mesatare e ponderuar e titujve shtetërorë (2018-Mars 2020)</i>	37
<i>Grafiku 44: Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore 2019 - Mars 2020 (në milion lekë)</i>	42
<i>Grafiku 45: Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore (në milionë lekë)</i>	43
<i>Grafiku 46: Rritja mujore e totalit të eksporteve, në përqindje.</i>	50
<i>Grafiku 47: Rritja mujore e totalit të importeve, në përqindje.</i>	51
<i>Grafiku 48: Ndryshimi vjetor i Inflacionit, në përqindje</i>	52
<i>Grafiku 49: Ecuria e stokut të depozitave 2019-2020, në përqindje</i>	54

I. ZHVILLIMET NË EKONOMINË SHQIPTARE

I.1 Ecuria e treguesve makroekonomikë për periudhën janar-maj¹ 2020

Në fillim të vitit 2020, e gjithë bota u përball me shpërthimin e pandemisë Covid-19. Në Shqipëri, COVID-19 u shfaq në fillim të muajit Mars dhe më 11 Mars Qeveria vendosi kufizime lëvizshmërie për të parandaluar përhapjen e mëtejshme. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj efekteve negative në ekonomi prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE të prekura rëndë nga pandemia.

Ngadalësimi i normës së PBB-së nuk pati ndikim në tregun e punës përgjatë vitit 2019, ndërsa për vitin aktual, situata duket se do nuk do të jetë aq e favorshme. Për tremujorin e parë të 2020, shkalla zyrtare e papunësisë për grup-moshën 15 vjeç e lart shënoi vlerën 11.4%, një rritje e lehtë prej 0.2% krahasuar me një tremujor me parë. Numri i të punësuarve për tremujorin e parë 2020 u rrit me 0.74% në terma vjetor për grup-moshën 15-64 vjeç. Të njëjtin trend rritës e ka vijuar edhe shkalla e punësimit duke arritur vlerën 61.4% për grupmoshën 15-64 vjeç, duke qëndruar pranë mesatares më të lartë për të paktën dymbëdhjetë vitet e fundit.

Një tjetër tregues i rëndësishëm që jep sinjale mbi rritjen ekonomike është treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) që në përputhje me metodologjinë, rezultatet e vrojtimeve të besimit për tremujorin e parë të vitit 2020 i takojnë informacionit të marrë në periudhën 1 – 10 mars, para se pandemia COVID-19 të prekte Shqipërinë dhe qeveria të shpallte masat parandaluese ndaj përhapjes së saj. Për këtë arsye, treguesit e besimit, e më në veçanti në sektorin e shërbimeve, nuk reflektojnë ndikimin negativ të pandemisë në ekonomi. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi nivelin 103.3 në T1-2020 duke pësuar një rritje prej 8.5 pikësh nga tremujori i kaluar dhe një rënie me 2.1 pikë përqindje në krahasim me T1-2019. Niveli aktual i TNE-së qëndron 3.3 pikë mbi mesataren afatgjatë, dhe rreth 0.1 pikë përqindje nën mesataren e 6 viteve të fundit. Rritja e nivelit të TNE-së i atribuohet vetëm përmirësimit të besimit në sektorin e shërbimeve. Besimi në sektorin e tregtisë rezultoi pothuajse i njëjtë me një tremujor më parë, ndërkohë që besimi në sektorët e industrisë, ndërtimit dhe besimi konsumator, shënoi rënie.

Eksportet e mallrave për periudhën janar - maj 2020 shënuan rënie prej -19.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjithashtu importet e mallrave shënuan rënie prej -17.1%. Këto zhvillime në tregtinë e jashtme të mallrave janë reflektuar dhe tek deficitin tregtar, i cili për periudhën janar-maj 2020 është përmirësuar me rreth 14.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa, norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 46.6%.

Inflacioni mesatar për periudhën janar-maj 2020 ishte +1.8%, nga +1.5% që rezultonte një vit më parë gjatë së njëjtës periudhë. Përgjatë kësaj periudhe, nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kontributin dhe rritjen vjetore më të lartë në inflacionin e përgjithshëm e ka pasur zëri i ushqimeve dhe pijeve jo alkolike.

¹ Analiza e zhvillimeve ekonomike në këtë seksion, bazohet në statistikat/informacionin më të fundit zyrtar të disponueshëm, në momentin e hartimit të këtij raporti.

Gjatë muajit prill të vitit 2020, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 5.9% krahasuar me muajin prill të vitit 2019. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.5%, ndërsa ai në valutë rritje prej 3.4%, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar. Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin prill të vitit 2020, ka shënuar rritje prej 6.4%, krahasuar me prillin e vitit 2019, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 2.2 pikë përqindje. Në prill 2020 rezultoi se rreth 51.4% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 48.6% përbëhet nga kreditë në valutë.

Stoku total i depozitave bankare, gjatë muajit prill të vitit 2020, ka shënuar rritje me 4.3% krahasuar me një vit më parë. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 5.1%, ndërsa ai në valutë është rritur me 3.7% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2019. Në prill 2020 rezultoi se rreth 46.3% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 53.7% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj.

Kursi mesatar i këmbimit i monedhës vendase ndaj Euros rezultoi mesatarisht 123.6 lekë/euro në pesëmujorin e parë të vitit 2020, duke pësuar rënie nga 124.3 lekë/euro që shënonte për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në terma vjetor, ecuria e euros në tregun vendas ka reflektuar mbiçmim të lekut prej 5.6% përgjatë Janar-Maj 2020. Kursi mesatar i këmbimit i monedhës vendase ndaj Dollarit Amerikan rezultoi mesatarisht 112.7 lekë/usd në pesëmujorin e parë të vitit 2020, duke shënuar rritje nga 109.9 lekë/usd që shënonte për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në terma vjetor, ecuria e dollarit amerikan në tregun ka reflektuar nënçmim të lekut prej 2.5% përgjatë pesëmujorit të parë 2020.

I.2 Pritshmëritë e treguesve makroekonomikë deri në fund të vitit 2020

Parashikimet kuantitative për impaktin negativ të COVID-19 në ekonomi, deri më tani, mbeten të rrethuara nga një marzh i lartë paqartësie. Pritet që impaktin më të lartë negativ ta kenë aktivitetet ekonomike që lidhen me sektorët e turizmit, transportit dhe tregtisë. Po gjithashtu pritet të preken konsiderueshëm edhe sektorët e industrisë përpunuese, industrisë nxjerrëse, shërbimeve të tjera dhe ndërtimit. Mundet që njëkohësisht disa sektorë të tjerë të kenë një impakt neto pozitiv, si p.sh. sektori i bujqësisë, kryesisht për shkak të efektit të zëvendësimit të mallrave të importit me ato të prodhuara në vend.

Ndërkohë nga pikëpamja e kërkesës agregate, impakti më i lartë negativ pritet në eksportet totale, sidomos ato të shërbimeve, dhe në konsumin final, por gjithashtu edhe investimet totale pritet të kenë një impakt negativ, ndonëse më të zbutur se sa dy komponentët e parë. Ndërsa, tkurrja në të njëjtën kohë e importeve, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve, pritet të zbusë në një masë të caktuar efektin neto negativ në rritjen reale të PBB.

Parashikimi i rritjes ekonomike, apo më saktë recensionit ekonomik për vitin 2020, si dhe të gjithë variablave të tjerë makroekonomikë, do të jetë subjekt rishikimesh në vijimësi të qartësimit të dinamikës së situatës. Pritet që vitin e ardhshëm (2021) ekonomia të rikthehet në ritmet pozitive të rritjes. Përgjatë periudhës afatmesme, rritja ekonomike pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të sjellë gjithashtu një efekt pozitiv, por marzhinal.

Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë.

Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.

Performanca pozitive e ekonomisë pritet të reflektohet edhe në përmirësimin e tregut të punës. Punësimi parashikohet të vijojë trendin rritës të periudhës së mëparshme, para goditjes nga pandemia, konform me trendin e pritshëm të aktivitetit ekonomik. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë.

II. POLITIKA FISKALE

II.1 Performanca fiskale për periudhën janar-maj 2020

Të ardhurat nga “Tatime dhe Dogana” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 5 mujorin 2020, u realizuan në vlerën 141.7 miliardë lekë, 13.5% ose 21.7 miliardë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019 dhe me realizim kundrejt planit të periudhës në masën 92.2% ose 12 miliardë lekë më pak. Rezultati negativ krahasuar me vitin e kaluar por krahasuar edhe me planin e vitit aktual, vjen si impakt i mbylljes së aktivitet ekonomik për shkak të situatë së pandemisë COVID 19, por edhe si pasojë e efekteve që solli tërmeti i fundvitit 2019.


Tabela 1: Të ardhurat Tatime & Dogana për periudhën Janar – Maj 2020 (në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 5 mujor 2019	Fakt 5 mujor 2020	Plan 5 mujor 2020	Diferenca 2020/2019	Ndryshimi në % 2020/2019	Diferenca Fakt/ Plan 2020	Ndryshimi në % Fakt/Plan 2020
TVSH TOTAL	54,965	47,922	51,017	-7,043	87.2%	-3,095	93.9%
<i>TVSH në import</i>	42,243	36,078	38,109	-6,165	85.4%	-2,031	94.7%
<i>TVSH brenda vendit</i>	12,722	11,844	12,908	-878	93.1%	-1,064	91.8%
Rimbursim TVSH	6,954	5,921	8,500	-1,033	85.1%	-2579	69.7%
Tatimi mbi fitimin	17,696	11,443	14,043	-6,253	64.7%	-2,600	81.5%
Akciza	16,982	15,810	16,715	-1172	93.1%	-905	94.6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	18,440	13,544	14,151	-4,896	73.4%	-607	95.7%
Taksa Nacional dhe te tjera	14,076	12,376	14,384	-1,700	87.9%	-2,008	86.0%
Taksat nacionale	13,059	11,585	13,177	-1,474	88.7%	-1,592	87.9%
Renta Minerare	1,017	791	1,207	-226	77.8%	-416	65.5%
Taksë Doganore	2,558	2,247	2,528	-311	87.8%	-281	88.9%
TOTALI TATIME + DOGANA	124,717	103,342	112,838	-21,375	82.9%	-9,496	91.6%
Kontributet e mbledhura (DPT)	39,050	38,362	40,892	-688	98.2%	-2530	93.8%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	163,767	141,704	153,730	-22,063	86.5%	-12,026	92.2%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Krahasuar me 5 mujorin 2019, performaca e te gjithë zërave të të ardhurave “Nga Tatimet dhe Doganat” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT), ka pësuar rënie. Rënie më të madhe e kanë pësuar zërat e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin me –35.3%, Tatimi mbi të ardhurat Personale me –22.6%, si dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar Neto në total –12.8% ose 7 miliardë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019.

Grafiku 1: Totali i të ardhurave Janar- Maj 2020/2019 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 5 mujorit kundrejt planit janë:

- Ulja e ndjeshme e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin si pasojë e shtyrjes së pagesës për shkak të situatës së pandemisë Covid-19.
- Ulja e të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale si pasojë e mosfunksionimit të pjesës dërrmuese të aktiviteteve ekonomike nga situata e krijuar prej Covid-19.
- Rënie e Kursit të këmbimit të monedhës Dollari Amerikan kundrejt monedhës vendase, përkatësisht në masën 2.6%, e cila ka dhënë efekte të vogla negative në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja e importeve për disa kategori mallrash.

Performanca e të ardhurave tatimore dhe doganore kundrejt planit 2020


Të ardhurat nga “Tatimet dhe Doganat” për periudhën Janar-Maj 2020 paraqiten me një realizim në masën 92.2% ose 12 miliardë lekë më pak se plani i periudhës. Performanca sipas taksave paraqitet si vijon:

- Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” në total, janë realizuar në vlerën 47.9 miliardë lekë, 6.1% ose 3.1 miliardë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin”, janë realizuar në vlerën 11.4 miliardë lekë, 18.5% ose 2.6 miliardë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Akciza”, janë realizuar në vlerën 15.8 miliardë lekë, 5.4% ose 905 milionë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale”, janë realizuar në vlerën 13.5 miliardë lekë, 4.3% ose 607 milionë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Taksat Nacionale dhe të tjera” janë realizuar në vlerën 12.4 miliardë lekë, 14% ose 2 miliardë lekë më pak se plani i periudhës.
- Të ardhurat nga “Taksat Doganore” janë realizuar në vlerën 2.2 miliardë lekë, 11.1% ose 281 milionë lekë më pak se plani i periudhës.

- Të ardhurat nga “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore” mbledhur nga DPT janë realizuar në vlerën 38.4 miliardë lekë, realizim në masën 93.8%, ose 2.5 miliardë kundrejt planit të periudhës.

Importi i taksuar arriti në vlerën 172.4 miliardë lekë, ndërsa eksportet total arritën në vlerën 102 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar importi i taksuar është ulur me 30 miliardë lekë ose 14.5%, dhe eksporti total është ulur me 29 miliardë lekë ose 22.3%. Sipas orientimit gjeografik, vendet Europiane, veçanërisht Italia dhe Greqia mbeten partnerët kryesorë në shkëmbimet tregtare.


Grafiku 2: Import i Taksuar dhe Eksport Total 2020/2019(në miliard lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të Ardhurat Doganore – Të ardhurat e mbledhura nga administrata doganore për 5 mujorin e vitit 2020 janë realizuar në vlerën 54.9 miliardë lekë, 12.5% ose 7.9 miliardë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019, dhe 6.2% ose 3.6 miliardë lekë më pak se plani.


Grafiku 3: Të ardhurat Doganore për Janar- Maj 2020, mujore dhe progresive (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Kontribuesit kryesor me efekt pozitiv në të ardhurat doganore janë importi i miellit dhe i grurit, dhjamra dhe vajra shtazore dhe vegjetale, sheqeri, duhan importi, fruta perime etj.

Grafiku 4: Kontribuesit kryesor në të ardhurat doganore Janar- Maj 2020/2019 (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në vlerën 2.2 miliardë lekë, 12.2% ose 311 milionë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019, dhe 11.1% ose 281 milionë lekë më pak se plani. Importi i taksuar është ulur me 14.5% krahasuar me periudhën Janar – Maj 2019.

Të ardhurat nga akciza janë realizuar në vlerën 15.8 miliardë lekë, 6.9% ose 1.2 miliardë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019, dhe 5.4% ose 900 milionë lekë më pak se plani. Ndikim kryesor ka pasur importi i duhanit që rezultoi me një rritje prej 7 ton ose +26.2% krahasuar me 5 mujorin e vitit 2019. Ndërkohë është rritur deklarimi i prodhimit vendas të duhanit me rreth 14 ton nga 10 ton të deklaruara në periudhën Janar-Maj 2019.

Tabela 2: Të dhëna mbi sasi të mallrave kryesorë të akcizës

Mallrat kryesorë të akcizës	Njesia	Sasia			
		5M 2019	5M 2020	Diferenca	%
Detergjentë parfumeri	Ton	24,838	27,199	2,361	9.5%
Karburante import	Ton	189,323	190,797	1,474	0.8%
Gaz lëngët	Ton	53,168	53,475	307	0.6%
Duhan importi	Ton	28	36	8	28.6%
Duhan prodhim vendi	Ton	10	14	4	40.0%
Kafe	Ton	3,313	3,302	(11)	-0.3%
Cigare	Ton	1,099	1,038	(61)	-5.6%
Pije alkolike import	mijë litra	407	312	(95)	-23.3%
Pije alkolike Prodhim Vendi	Ton	294	187	(107)	-36.4%
Bateritë, Akumulatorët	Ton	1,408	1,218	(190)	-13.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grup-produktet me kontribut pozitiv në të ardhura rezultuan: duhan importi, duhan prodhim vendi, gaz lëngët si dhe kimikatet inorganike kimike. Ndërsa produktet me efekt negativ në të ardhura rezultuan: karburanti prodhim vendi, karburant import, cigare, birra importi dhe birra prodhim vendi, kafe dhe verë importi dhe verë prodhim vendi.

Tabela 3: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga Akciza/Diferencat Janar-Maj 2020/2019

	Produktet me kontribut Pozitiv			milione lekë	
	Njësia	Sasi	%	Akciza	%
Duhan Importi	Ton	7	26.20%	40	25%
Duhan Prodhim Vendi	Ton	5	51.70%	20	82.50%
Gaz i Lëngët	Ton	308	0.60%	7	2.90%
Kimikatet inorganike kimike	Ton	-2,856	-6.60%	1	118.70%
Efekti				68	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (20120)

Tabela 4: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga Akciza/ Diferencat Janar-Maj 2020/2019

	Produktet me kontribut Negativ			milione lekë	
	Njësia	Sasi	%	Akciza	%
Karburante Prodhim Vendi	Ton	-36,542	-89.5%	-1,496	-90.4%
Karburante Import	Ton	1,474	0.8%	-523	-7.0%
Cigare	Ton	-62	-5.6%	-317	-5.2%
Birrë Importi	Ton	-2,775	-22.5%	-98	-23.7%
Birrë Prodhim Vendi	Ton	-2,731	-22.8%	-57	-21.9%
Efekti				-2,490	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë realizuar në vlerën 36.1 miliardë lekë, 14.6% ose 6.2 miliardë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019, dhe 5.3% ose 2 miliardë lekë më pak se plani. Rënia e madhe e importit të energjisë elektrike ka ulur TVSH e arkëtuar në import me efekt negative 1.3 miliardë lekë. Po kështu, rënia e importit të automjeteve ka ulur TVSH-në me 0.5 miliardë lekë. Karburanti import mbuloi rreth 97.8% të konsumit gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2019 krahasuar me 82.3% që ishte ky tregues vitin e kaluar. Grup-produktet me kontribut pozitiv në të ardhurat nga TVSH në import rezultuan: mielli dhe gruri, dhjamrat shtazore, sheqeri, fruta – perimet, etj.

Tabela 5: Kontribuesit pozitivë në të ardhurat nga TVSH/Diferencat Janar-Maj 2020/2019

	Produktet me kontribut negativ				
	Njësia	Sasi	%	TVSH/milione lekë	%
Mielli dhe Gruri	Ton	45,561	56.2%	257	52.6%
Dhjamra dhe Vajra shtazore dhe vegjetale	Ton	3,035	18.3%	118	32.3%
Sheqeri	Ton	4,160	18.4%	76	38.2%
Fruta Perime	Ton	(1,688)	-2.6%	41	4.7%
Bulmet, vezë, mjaltë	Ton	(240)	-2.9%	25	8.4%
				517	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Tabela 6: Kontribuesit negativë në të ardhurat nga TVSH/ Diferencat Janar-Maj 2020/2019

	Produktet me kontribut negativ				
	Njësia	Sasi	%	TVSH/milione lekë	%
Energji Elektrike	MV/orë	(596,636)	-38.9%	(1,342)	-53.7%
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	Ton	28,200	18.0%	(543)	-16.3%
Automjeteve të përdorura	Ton	1,652	12.5%	(490)	-23.1%
Veshje, Tekstile	Ton	(2,918)	-30.3%	(439)	-27.6%
Elektro shtepiAKE	Ton	(2,185)	-29.5%	(249)	-28.2%
				(3,063)	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën 791 milionë lekë, 22.2% ose 226 milionë lekë më pak krahasuar me 5 mujorin e vitit 2019, dhe 34.5% ose 416 milionë lekë më pak se plani. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur me 49 milionë lekë, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar me rreth 14 mijë ton dhe janë ulur me 251 milionë lekë si rezultat i rënies së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 3.51 lekë/kg në 2.51 lekë/kg. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 35 milionë lekë për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 166 mijë ton si dhe janë rritur me 4 milionë lekë, për shkak të rritjes së lehtë të çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tabela 7: Të dhëna për Rentën Minerare, naftë bruto dhe minerale të tjera (në mijë lekë)


RENTA	Sasia në ton				Të ardhura nga Renta në mijë lekë				Efektet		
	2019	2020	Diferenca 2020/2019	në %	2019	2020	Diferenca 2020/2019	në %	Ndryshim SASI	Ndryshim ÇMIM	TOTAL
Rentë minerare Naftë Bruto	237,205	251,406	14,202	6.0%	833,547	631,919	(201,628)	-24.2%	49,906	(251,534)	(201,628)
Rentë minerare Minerale të tjera	896,787	730,504	(166,283)	-18.5%	190,038	158,979	(31,058)	-16.3%	(35,237)	4,179	(31,058)
Totali	1,133,992	981,910	(152,081)	-13.4%	1,023,585	790,899	(232,686)	-22.7%	14,669	(247,356)	(232,686)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të Ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore (përfshirë kontributet) për 5 mujorin e vitit 2020 janë realizuar në vlerën 86.8 miliardë lekë, 14.1% ose 14.2 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe 8.8% ose 8.4 miliardë lekë më pak se plani i vitit 2020.




Grafiku 5: Të ardhurat nga Tatimet Janar- Maj 2020, Mujore dhe Progressive (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga TVSH-ja neto brenda vendit janë realizuar në vlerën 11.8 miliardë lekë, 6.9% ose 878 milionë lekë më pak se 5 mujori i vitit 2019 dhe me një realizim të planit të periudhës në masën 91.8% ose rreth 1 miliardë lekë më pak. Rimbursimi i TVSH-së krahasuar me 5 mujorin e vitit të kaluar është 85.1%, ose 1 miliardë lekë më pak dhe 30.3% ose 2.6 miliardë lekë më pak krahasuar me planin e vitit 2020.


Grafiku 6: Të ardhura nga TVSH dhe rimbursimi i TVSH, 5 mujori në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në vlerën 11.4 miliardë lekë, 35.3% ose 6.2 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 18.5% ose 2.6 miliardë lekë më pak se plani i periudhës. Situata e pandemisë Covid 19 dhe masat e marra nga qeveria në ndihmë të biznesit, janë reflektuar në rënien e tatim fitimit të paguar nga ana e biznesit nga muaji mars 2020.


Grafiku 7: Të ardhurat nga Tatim Fitimi, 5 mujori në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar 13.5 miliardë lekë, 26.6% ose 4.9 miliardë lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 4.3% ose 600 milionë lekë më pak se plani i periudhës. Rritja më e madhe ka ardhur për shkak të tatimit mbi dividendin. Të ardhurat e të punësuarve në sektorin publik e privat kanë ndryshuar përkatësisht me 3.5% dhe -5.6%. Me përjashtim të të ardhurave nga interesat, të cilat janë rritur me 3.2%, të gjitha zërat e tjerë të të ardhurave personale kanë pësuar rënie.


Grafiku 8: Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Nga “Taksat Kombëtare” janë realizuar 11.6 miliardë lekë, 11.3% ose 1.5 miliardë lekë më pak se 5-mujori i vitit 2019 dhe 12.1% ose 1.6 miliardë lekë më pak se plani.


Grafiku 9: Të ardhurat 5 mujore nga Taksat nacionale, në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Të ardhurat nga “Kontributet e D.P.T-së” janë realizuar në vlerën 38.4 miliardë lekë, 688 milionë lekë ose 1.8% më pak se 5-mujori i vitit 2019 dhe 6.2% ose 2.5 miliardë lekë më pak se plani. Rezultati me ulje vjen si pasojë e situatës aktuale ku gjatë muajve mars dhe prill ka patur rritje të numrit të të larguarve nga puna për shkak të pandemisë botërore Covid 19.

Grafiku 10: Të ardhurat nga kontributet e mbledhura nga DPT, në vite (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

II.2 Pritshmëritë fiskale deri në fund të vitit 2020

Bazuar në performancën e 5 mujorit Janar-Maj 2020 si dhe në analizën e faktorëve që mund të impaktojnë realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore në 7 mujorin në vijim të vitit 2020, realizimi i të ardhurave që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pritet në nivelin 83,3% krahasuar me buxhetin fillestar 2020. Pra, parashikohet deficit në të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat prej -19,6% ose -64 miliardë lekë dhe në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore prej -8,73% ose -9 miliardë lekë.

Ndër faktorët kryesorë të cilët do të ndikojnë në realizimin e pritshëm të të ardhurave deri në fund të vitit 2020, janë:

- ✓ Efektet në ekonomi nga Pandemia e Covid-19 do të jenë një nga faktorët kryesorë ndikues në mungesën e performancës së të ardhurave, për shkak të ndikimit direkt në uljen e qarkullimit dhe të konsumit, duke reduktuar të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Taksat, Kontributet etj.
- ✓ Çmimi i mineraleve kryesisht naftes por edhe ulja e kursit të këmbimit të monedhave të huaja kundrejt lekut, kanë ndikuar dhe do ndikojnë në reduktimin e bazes së llogaritjes së detyrimeve tatimore për mallrat e importit.
- ✓ Shtyrja e pagesave të kesteve të tatimit mbi fitimin për vitin 2020 për shume industri do reduktoje të ardhurat në këtë ze.
- ✓ Efektet negative mbi ekonominë e vendit të situatave konfliktuale politike. Kjo situatë reflektohet në sjelljen e tatimpaguesve dhe nivelin e zbatimit vullnetar të ligjit nga ana e tyre.

III. BUXHETI I VITIT 2020

III.1 Shpenzimet e Përgjithshme Buxhetore gjatë periudhës janar-maj 2020

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e pestë të vitit 2020, arritën në rreth 187.08 miliard LEK me një realizim në masën 90 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ky zë ka rezultuar 0.5 përqind më i ulët ose 901 milion LEK më pak. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 5 mujorin e vitit 2020 u realizuan në masën 34.1 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe 33.5 përqind të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr.15 datë 15.04.2020 (AN nr.15).

Tabela 8: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2020 (në milion LEK)

Emërtimi	Maj 2020		Diferenca		Viti 2020					
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	në % mbi Plan	Plani Vjetor Buxhet Fillestar	Plani Vjetor AN nr.6	Plani Vjetor AN nr.15	% e realizimit vjetor Buxhet Fillestar	% e realizimit vjetor AN nr.6	% e realizimit vjetor AN nr.15
Të Ardhurat e Përgjithshme	172,778	160,749	-12,029	93.0%	509,675	489,675	489,675	31.5%	32.8%	32.8%
Shpenzimet e Përgjithshme	207,961	187,078	-20,883	90.0%	549,374	558,374	558,373	34.1%	33.5%	33.5%
Shpenzimet Korente	168,059	166,541	-1,518	99.1%	446,035	448,335	446,223	37.3%	37.1%	37.3%
Shpenzimet Kapitale	20,162	20,537	375	101.9%	81,639	80,939	75,950	25.2%	25.4%	27.0%
Deficit/Suficit	-35,183	-26,329	8,854	74.8%	-39,699	-68,699	-68,699	66.3%	38.3%	38.3%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Tabela 9: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 5 mujorin e vitit 2019 dhe 2020 (në milion LEK)

Emërtimi	Fakt Maj 2019	Maj 2020		Diferenca Fakt Plan 2020	Në % ndaj Plan 2020	Diferenca Fakt 2020 Fakt 2019	Në % ndaj Fakt 2019
		Plan	Fakt				
Të Ardhurat e Përgjithshme	188,316	172,778	160,749	-12,029	93.0%	-27,567	85.4%
Shpenzimet e Përgjithshme	187,979	207,961	187,078	-20,883	90.0%	-901	99.5%
Shpenzimet Korente	165,834	168,059	166,541	-1,518	99.1%	707	100.4%
Shpenzimet Kapitale	22,108	20,162	20,537	375	101.9%	-1,571	92.9%
Deficit/Suficit	338	-35,183	-26,329	8,854	74.8%	-26,666	-7899.8%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 11: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet korente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim respektivisht në masën 99.1 përqind dhe 101.9 përqind të planit të periudhës. Ndërkohë që, në terma vjetorë ato janë realizuar përkatësisht në: 37.3 përqind dhe 25.2 përqind të planit vjetor sipas Buxhetit fillestar, 37.3 përqind dhe 27 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15.

Shpenzimet korente për periudhën 5 mujore të vitit 2020 rezultuan në rreth 166.54 miliard LEK, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 0.4 përqind më i lartë ose 707 milion LEK më shumë.


Shpenzimet kapitale për muajin e pestë të vitit 2020 paraqesin një realizim në masën rreth 20.5 miliard LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë është 7.1 përqind më i ulët ose rreth 1.57 miliard LEK më pak.

Grafiku 12: Shpenzimet korente dhe kapitale Plan vs Fakt (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 13: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme, për periudhën 5 mujore 2020




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet korente në raport me planin 5 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 99.1 përqind, duke rezultuar në rreth 166.54 miliard LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 5 mujor janë përkatësisht:


- ✓ shpenzimet e tjera sociale me 170.1 përqind të planit të periudhës dhe 81.2 përqind të planit vjetor fillestar dhe AN nr.15.
- ✓ shpenzimet e personelit me 98.2 përqind të planit të periudhës, 37.7 përqind të planit vjetor fillestar dhe 38.2 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15.
- ✓ shpenzimet për interesa me 98 përqind të planit të periudhës, 31.9 përqind të planit vjetor fillestar dhe 31.5 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15.

Grafiku 14: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku 15: Struktura e shpenzimeve korente, për periudhën 5 mujore 2020



Shpenzimet e Personelit gjatë muajit Maj 2020, përfaqësuan 18.8 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 31.36 miliard LEK, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 5 mujore në masën 98.2 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë është 0.9 përqind më i lartë ose 291 milion LEK më shumë.


Grafiku 16: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Paga në fund të muajit të pestë të vitit 2020 u realizuan në masën rreth 26.9 miliard LEK, duke qenë 1 përqind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2019, ose 265 milion LEK më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën 1.3 përqind më të larta se një vit më parë ose 56 milion LEK më shumë. Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku, është në nivelin 98.2 përqind krahasuar me planin e periudhës ose 37.7 përqind e planit vjetor fillestar dhe 38.2 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15.


Grafiku 17: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Interesa gjatë periudhës 5 mujore 2020 kanë arritur në masën rreth 13.05 miliard LEK duke përfaqësuar 7.8 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 98 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, në nivel 5 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 31.9 përqind e planit vjetor sipas Buxhetit fillestar dhe 31.5 përqind e planit vjetor sipas AN nr.15. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë ka rezultuar 7.6 përqind më i ulët ose 1.07 miliard LEK më pak.

Grafiku 18: Shpenzimet për Interesa (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë periudhës 5 mujore të vitit 2020, kanë shënuar një realizim në masën rreth 16.66 miliard LEK ose 90.7 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 33.4 përqind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 33.8 përqind e planit vjetor sipas AN nr.15. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ky zë ka rezultuar 8 përqind më i ulët, ose rreth 1.46 miliard LEK më pak.


Grafiku 19: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të muajit të pestë të vitit 2020, arritën nivelin 337 milion LEK, me një realizim në masën 91.7 përqind të planit të periudhës ose 31 milion LEK më pak. Në raport me planin vjetor, ky zë është realizuar në masën 26.1 përqind të planit vjetor fillestar dhe 25.2 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për subvencione rezultojnë 31 përqind më të ulëta ose 152 milion LEK më pak.

Grafiku 20: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet për Fondet Speciale për muajin e pestë të vitit 2020 rezultuan në nivelin rreth 67.95 miliard LEK, me një realizim prej 93 përqind kundrejt planit të periudhës. Përkatësisht:

- shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 50.5 miliard LEK,
- shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 16.6 miliard LEK, dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve në 796 milion LEK.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019, shpenzimet për sigurime shoqërore janë 59 milion LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 146 milion LEK më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 315 milion LEK më të ulëta.

Grafiku 21: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Shpenzimet për Papunësinë për 5 mujorin e vitit 2020 janë realizuar në masën 8 miliard LEK. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën rreth 7.77 miliard LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndhmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 5 mujore të vitit 2020 u realizuan në masën rreth 10.6 miliard LEK duke rezultuar 106.1 përqind e planit të periudhës ose 608 milion LEK më shumë. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 50.5 përqind e planit vjetor fillestar dhe AN nr.15. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 26.6 përqind ose rreth 2.2 miliard LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik për periudhën 5 mujore të vitit 2020 u realizuan në masën 445 milion LEK duke rezultuar 92.4 përqind e planit të periudhës ose 44.5 përqind e planit vjetor fillestar dhe AN nr.15. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rënie në masën 17.9 përqind ose 97 milion LEK më pak në terma nominalë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 5 mujore të vitit 2020 u realizuan në masën 920 milion LEK duke rezultuar 92 përqind e planit të periudhës ose 46 përqind e planit vjetor fillestar dhe AN nr.15.

Grafiku 22: Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Shpenzimet kapitale, për muajin e pestë të vitit 2020 kanë një realizim në masën rreth 20.5 miliard LEK ose 101.9 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, financimi i brendshëm u realizua në masën rreth 13.8 miliard LEK ose 93.7% e planit të periudhës, financimi i huaj u realizua në masën rreth 6.3 miliard LEK ose 124% e planit të periudhës.

Krahasuar me planin vjetor, për 5 mujorin e vitit 2020 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën 25.2 përqind të planit vjetor fillestar dhe 27 përqind të planit vjetor sipas AN nr.15. Financimi i brendshëm është realizuar në masën 27 përqind e planit vjetor fillestar dhe 29.9 përqind e planit vjetor sipas AN nr.15. Financimi i huaj është realizuar në masën 21.6 përqind e planit vjetor fillestar dhe 22.1 përqind e planit vjetor sipas AN nr.15.

Grafiku 23: Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Grafiku 24: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e shpenzimeve publike faktike për muajin Maj të vitit 2020. Shpenzimet korente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 89 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale përbëjnë 11 përqind.


Grafiku 25: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskal të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme për muajin e pestë të vitit 2020 është rreth 187.08 miliard LEK ose 90 përqind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një deficit buxhetor prej rreth 26.3 miliard LEK. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Grafiku 26: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficit/suficiti - Plan vs Fakt 5 Mujori 2019 (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


III.2 Financat Vendore gjatë janar-maj 2020

Procesi i menaxhimit të financave publike në nivel vendor ka hyrë në një fazë të re konsolidimi nën regjimin e Ligjit nr.68 datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë kuadër Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndjek vazhdimisht treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor me qëllim monitorimin dhe asistencën e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Prandaj referuar të dhënave fiskale të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë është realizuar analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të 5 mujorit 2020 në nivel kombëtar të buxhetit vendor.

Të ardhurat vendore

Për 5 mujorin e vitin 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura masën 6 995 milionë lekë, shifër kjo që është rreth 4.3 miliard lekë më pak ose rreth 38 përqind më të ulëta se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2019. Edhe në raport me planin e periudhës shikojmë që ka një mosrealizim të të ardhurave të pushtetit vendor dhe ky mosrealizim është afërsisht 3.5 miliard lekë ose 33% më i ulët se plani i miratuar për 5 mujorin 2020. Këto efekte negative në të ardhurat vendore për 5 mujorin e parë të vitit 2020 kanë ardhur si pasojë e ngjarjeve të jashtëzakonshme që kanë prekur territorin e vendit tonë si; tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe gjendja e pandemisë botërore COVID-19 e shfaqur që në tremujorin e parë të vitit 2020. Në këtë situatë njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë luajtur një rol thelbësor jo vetëm në realizimin e shërbimeve publike por edhe në ofrimin e paketave lehtësuese për detyrimet e qytetarëve dhe bizneseve ndaj taksave e tarifave vendore.


Grafiku 27 Të ardhurat sipas burimit për njësitë vendore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të këtyre të ardhurave. Të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për 5 mujorin e parë të vitit nga taksat lokale, janë ato që zënë pjesën më të madhe ose 72% për vitin 2019 dhe 75.5% për vitin 2020 të shumës totale të këtyre të ardhurave. Nga ana tjetër, nga realizimi faktik i 5 mujorit të parë të vitit 2020, rezulton se nga taksa e biznesit të vogël janë mbledhur 306 milion lekë dhe nga taksa e pasurisë (ndërtesa) janë mbledhur 1.4 miliard lekë. Parë në këtë këndvështrim, rënia e efektshërisë së mbledhjes së taksave nga pushteti vendor ka ardhur si pasojë e kushteve të krijuara nga pandemia. Në këtë mënyrë për të ardhurat vendore viti 2020 është një vit përjashtimor, ku vetëm taksat vendore janë rreth 3.1 miliard lekë më pak se njëjta periudhë e një vitit më parë. Gjithashtu, duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave vendore, rënia në raport me një vit më parë është rreth 47% tek taksa mbi pasurinë dhe rreth 37% në zërin e taksave lokale.

Grafiku 28: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Duke marrë në analizë të ardhurat e NJVQV-ve sipas burimit konstatohet sa mëposhtë vijon:

Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlerë por dhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën përbëjnë thelbin e reformës mbi këtë burim financimi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë, nëse marrim në analizë 5 mujorin në vite do të kemi rezultatet si në grafikun 3 të mëposhtëm:

Grafiku 29: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Duke analizuar në raport me një vit më parë, nga taksa mbi pasurinë është siguruar rreth 1.2 miliard lekë më pak të ardhura, pasojë kjo e situatës së krijuar nga pandemia gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Në total për 5 mujorin e vitit 2020 nga taska mbi pasurinë pushteti vendor ka siguruar rreth 1.6 miliard lekë, rënia me 47% në raport me një vit më parë e të ardhurave të kësaj takse, vjen si pasojë e ngjarjes së jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia. Megjithatë, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të synojnë rikuperimin për një periudhë afatmesme të kësaj problematike të krijuar në këtë vit.

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi mbi biznesin e vogël në vite si pasojë e ndryshimeve fiskale, në vite ka patur një rënie në peshën që zë në buxhetin vendor. Në këto kushte mund të evidentohet lehtësisht në grafikun e mëposhtëm nr. 4, ndryshimi në vite i këtij burimi:

Grafiku 30: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Duke analizuar trendin e ndryshimit, në krahasim me 5 mujorin e vitit 2019, gjatë vitit 2020 nga kjo taskë janë siguruar rreth 306 milion lekë ose 8% më shumë. Ky burim pamvarësisht se zë vetëm 4.3% të të ardhura vendore, ka pësuar një rritje me rreth 24 milion lekë. Vlen për tu theksuar fakti që si pasojë e situatës së krijuar taksa e biznesit të vogël është i vetmi burim i të ardhurave që ka shënuar rritje në raport me një vit më parë.

Taksat Lokale

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithmonë e më shumë po konsolidohen në këndvështrimin financiar dhe për këtë e dëshmon rritja e të ardhurave nga takasta lokale si një ndër burimet më të rëndësishme të financimit. Në total, të ardhurat nga taksat vendore zënë rreth 75.4% të të ardhurave të veta vendore, tregues ky i cili reflektohet si në grafikun 5 e mëposhtëm:

Grafiku 31: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit e pushtetit vendor



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Të ardhurat nga taksat lokale në 5 mujorin e parë të vitit 2020 kanë arritur në rreth 5.2 miliard lekë, ose rreth 3.1 miliard lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. Kjo rënie me rreth 37% tregon vështirësitë e krijuara për të ardhurat vendore nga situata e pandemisë dhe gjithashtu rolin e rëndësishëm që kanë patur njësitë e vetëqeverisjes vendore në përballimin me sukses të situatës. Vazhdimisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vënë theksi jo vetëm në mënyrën e përdorimit të fondeve publike por edhe në rëndësinë që ka rritja e të ardhurave të veta vendore në zhvillimin cilësorë të shërbimeve që ofron pushteti vendor për qytetarët. Njësitë e vetëqeverisjes vendore synojnë rikuperimin e gjendjes financiare brenda një periudhe afatmesme me qëllim rikthimin e trendit normal të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Shpenzimet vendore

Shpenzimet e Pushtetit Vendor janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Ndër vite shpenzimet e pushtetit vendor janë një tregues në rritje të lehtë dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që pushteti vendor ofron për qytetarët e saj.

Buxheti vendor për 5 mujorin e parë të vitit 2020, nga të dhënat faktike të thesarit rezulton të jetë realizuar në masën 17.2 miliard lekë ose 6.4 miliard më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. Nga analiza e të dhënave të thesarit vihet re që pjesën më të madhe të kësaj rënie të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë të shpenzimeve vendore lidhet me situatën e krijuar nga pandemia dhe ndalimi i shume punëve publike në formën e investimeve për të cilat kanë marrë anagazhim njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo evidentohet qartë nëse analizojmë në nivel llogarie, ku pjesën më të madhe të rënie së shpenzimeve e ka zëri i shpenzimeve për investime e cila ka një rënie me rreth 61% më më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019.


Grafiku 32: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritimi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Shpenzimet e pushtetit vendor në vite sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qendrueshmërisë së shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë përmes përdorimit në formën e shpenzimeve operative. Viti 2020, përbën një vit të veçantë për treguesit fikalë në tërësi dhe sigurisht këtu nuk bëjnë përjashtim njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sipas të dhënave në nivel llogarie ekonomike, struktura e shpenzimeve rezulton si në grafikun më poshtë:

Grafiku 33: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Mëposhtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 5 mujorit të vitit 2020 dhe vitit 2019.

Tabela 10: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milion LEK)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 5 mujori		Diferenca	
		2020	2019	2020 / 2019	% e 2020 kundrejt 2019
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	6,995	11,349	-4,354	62%
I.1	Taksa mbi pasurinë	1,409	2,665	-1,256	53%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	306	282	24	108%
I.3	Taksa Lokale	5,280	8,401	-3,121	63%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	17,202	23,652	-6,450	73%
II.1	Shpenzime Korente	14,158	15,828	-1,670	89%
	Personeli	9,239	8,932	307	103%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	4,464	6,327	-1,863	71%
	Subvencione	57	61	-4	93%
	Te tjera	398	508	-110	78%
II.2	Shpenzime Kapitale	3,044	7,824	-4,780	39%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020);

Shpenzimet e Personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësive të veqeverisjes vendore. Për 5 mujorin e vitit 2020 këto shpenzime janë realizuar në masën 9.2 miliard lekë ose rreth 307 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e një vitit më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2020, argumentohet me faktin se tashmë njësitet vendore me shtimin e kompetencave dhe funksioneve që ata duhet të ushtrojnë kanë të domosdoshëm shtimin e personelit që ofron këto shërbime. Gjithashtu, rritja e shpenzimeve të personelit në këtë periudhë ka ardhur si rezultat i nevojës për shërbime urgjente dhe të drejtpërdrejta tek familjet në nevojë nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Shpenzimet Operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve ku rezultojnë me një rritje të ndjeshme sipas të dhënave faktike të thesarit. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 32% të shpenzimeve korrente në total për 5 mujorin e parë të vitit 2020, një pjesë kjo jo e vogël për buxhetin njësive të vetëqeverisjes vendore. Këto shpenzime gjatë periudhës 5 mujore të vitit 2020 janë realizuar afërsisht në masën 4.4 miliard lekë ose rreth 1.8 miliard lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë njësitet e vetëqeverisjes vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipërme në raport me 5 mujorin e parë të vitit 2019, këto shpenzime për të njëjtën periudhë në vitin 2020 kanë rënie në zërin të tjera me 22% dhe në zërin subvencione me rreth 1%. Në vlerë absolute shpenzimet për subvencione shpenzimet faktike të pushtetit vendor për subvencione gjatë 5 mujorit të parë 2020 janë realizuar rreth 57 milion lekë ose 4 milion lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019. Gjithashtu, shpenzimet e tjera janë realizuar në masën 398 milion lekë ose 110 milion lekë më pak se 5 mujori i parë i vitit 2019.

Shpenzimet Kapitale janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor por edhe për shkak sepse këto shpenzime sjellin në mënyre direkt dhe indirekt zhvillim ekonomik dhe për rrjedhojë afektojnë mirëqënien e qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me një vit më parë gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2020

shpenzimet për investime janë ulur me rreth 4.7 miliard lekë ose 61% më pak. Një rënie e madhe e shpenzimeve për investime ka ardhur si pasojë e bllokimit të ndodhur nga pandemia e COVID-19. Në pjesën e dytë të vitit 2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të synojnë arritjen e ritmit vjetor të planifikuar të investimeve. Rritja e peshës së tyre në raport me totalin e shpenzimeve vendore përbën një shtysë të rëndësishme në angazhimin për zhvillimin infrastrukturor përmes pushtetit vendor.

Si përfundim, vlen të theksohet fakti që treguesit e vitit 2020, përbëjnë një vit përjashtimor për treguesit fiskal të pushtetit vendor, si pasojë e situatës së krjuar nga Pandemia COVID-19. Roli i njësisve të vetëqeverisjes vendore në menaxhimin e situatës ka qënë thelbësor dhe gjithashtu ka ndihmuar në lehtësimin e barrës ekonomike të qytetarëve e bizneseve përmes politikave fiskale të favorshme.

III.3 Fondi Rezervë, Fondi i Kontigjencës, Fondi i Veçantë & Fondi për Rritjen e Pagave

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2020, janë përfshirë edhe shpenzimet e realizuara nga përdorimet e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, të fondit të rindërtimit dhe të fondit të kontigjencës. Më konkretisht:

FONDI REZERVË – Ligji nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën 1.7 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin e tij nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme.

Me Aktin Normativ nr.6 datë 21.03.2020 si edhe me Aktin Normativ nr.15 datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime ligjin nr.88/2019 ‘Për buxhetin e vitit 2020’”, Fondi Rezervë ndryshoi në masën 16.2 miliard lekë, ndërkohë që është përcaktuar dhe përdorimi i tij si më poshtë:

- (i) 1 700 milione leke për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme.
- (ii) 13 500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19.
- (iii) 1 000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-covid 19

Deri në datën 30 Qershor 2020 ai është përdorur si mëposhtë:

- *Fondi Rezervë për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për një shumë prej rreth 970.2 milionë LEK ose rreth 57.1 përqind e tij. Nga këto:*
 - ✓ *rreth 409.2 milionë LEK janë përdorur për shpenzime korente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme),*
 - ✓ *rreth 561 milionë LEK për investime publike.*
- Gjendja e papërdorur e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në datën 30 qershor 2020, rezulton 729.8 milionë LEK.

- *Fondi Rezervë i parashikuar si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19, prej 13.5 miliard lekë, është përdorur nëpërmjet 3 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për një shumë prej 13.456 miliard lekë.*
- Gjendja e papërdorur e këtij fondi, në datën 30 qershor 2020, rezulton 44 milionë LEK.

- *Fondi Rezervë i planifikuar për emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-Covid 19, prej 1 miliardë lekë, është përdorur me 5 3 Vendimeve të Këshillit të Ministrave në masën 184 milionë lekë.*

Gjendja e papërdorur e këtij fondi, në datën 30 qershor 2020, rezulton 815.9 milionë LEK.

FONDI RINDËRTIMIT – Ligji nr.88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” miratoi Fondin e Rindërtimit prej 20 miliardë LEK, për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, i cili përbëhet nga:

- ✓ *Grante 7 miliardë lekë*
- ✓ *Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë*

- Nga Fondi i Rindërtimit (shpenzime) prej 13 miliardë lekë, deri tani janë akorduar rreth 12.4 miliard lekë përmes 13 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për procesin e rindërtimit/ndërtimit pas dëmtimeve nga tërmeti i datës 26.11.2019.
- Nga Fondi i Rindërtimit (grante), deri në këtë moment janë akorduar 510.2 milion lekë përmes 1 Vendimi të Këshillit të Ministrave, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njërive të banimit në ndërtesa në Bashkitë Kamëz e Kavajë.

KONTINGJENCA PËR RISQET E BORXHIT – Për vitin 2020, ky fond prej 4 000 milionë lekësh që përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa, rezultoni i papërdorur deri në 30.06.2020.

III.4 Pritshmëria e Shpenzimeve Buxhetore deri në fund të vitit 2020

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2020, vlerësuar mbi bazën e ecurisë dhe performancës së tyre gjatë periudhës Janar-Maj 2020, paraqesin një pritshmëri përgjithësisht në linjë me parashikimet ligjit të rishikuar të buxhetit 2020. Shpenzimet kapitale, paraqiten disi nën pritshmëritë fillesatare për realizimin e planit vjetor. Për shkak të situatës së krijuar nga gjendja e Covid-19, për një pjesë të madhe të kontratave të investimeve janë pezulluar punimet. Pritet që me normalizimin e situatës punimet të rifillojnë, dhe kontratat të realizohen kundrejt planit vjetor, në gjysmën e dytë të vitit 2020. Sidoqoftë, një parashikim më i saktë lidhur me pritshmërinë e realizimit të tyre deri në fund të vitit 2019 do të jetë i mundur vetëm pas analizës së ecurisë 9 mujore të tyre. Kjo, duke konsideruar tremujorin e fundit të çdo viti buxhetor, si periudhën me performancë më të lartë përse i përket investimeve publike në tërësi dhe atyre në infrastrukturë në veçanti.

Sjellim në vëmendje se deri në këtë moment, vetëm gjatë dy mujorit mars-prill 2020, ligji i buxhetit 2020 është rishikuar dy herë, deri në këtë moment, përkatësisht përmes Aktit Normativ nr.6 datë 21.03.2020 dhe Aktit Normativ nr.15 datë 15.04.2020. Më konkretisht:

Akti Normativ nr.6 datë 21.03.2020, pati si qëllim:

- Të akordojë një fond prej 6.5 miliardë lekë në zërin e ri “Kontingjenca për paketën sociale anti-COVID19” si paketë e parë sociale, e cila përdoret me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ky fond i dedikohet financimit të masave me karakter social, në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi.*

- b) *Miratimin e mbeshtetjes per biznesin, ne formen e instrumentit të Garancisë Sovrane, në masën 11 miliardë lekë (100 milionë USD), si garanci për kompanitë që u gjenden përballë vështirësisë për pagesën e pagave të punonjësve.*
- c) *Alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore për përballimin të situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, përmes financimit të sektorit të shëndetësisë për pajisje, medikamente, materiale mjekësore dhe shërbimet e tjera të nevojshme, si dhe financimin e paketave sociale, në kuadër të saj.*
- d) *Të reflektojë reduktimin në masën 20 miliardë lekë, të zërit “Të ardhura tatimore”, si pasojë e ngadalësimit të pritshëm në mbledhjen e tyre.*
- e) *Të reflektojë rritjen e shpenzimeve të përgjithshme, buxhetore në masën 9 miliardë lekë ku, përfshirë edhe rialokimet e brendshme, mbeshtetja financiare për masat Anti-Covid 19 arrihet në 12 miliardë leke.*
- f) *Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e deficitit buxhetor në nivelin 68.7 miliardë leke, ose 3.9 përqind të PBB, nga përkatësisht 39.7 miliardë lekë ose 2.2% e PBB që ishin sipas buxhetit fillestar.*
- g) *Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritshëm prej rreth 68.8% e PBB, nga 65.4% të PBB që pritej sipas buxhetit fillestar.*
- *Rritja e borxhit publik total të pritshëm në këtë AN, si raport ndaj PBB, kundrejt buxhetit fillestar reflekton: (i) rritjen e deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto; (ii) rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar; dhe (iii) reduktimin e PBB nominale të parashikuar.*
 - *Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në LOB për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët se sa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë AN, ku borxhi publik i pritshëm 2020 prej rreth 68.8% e PBB është më i lartë se sa ai i vitit 2019 prej 65.9% të PBB, është në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme përcaktuar në Nenin 4//4, pika (a) e LOB (Ligji nr.9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar), rast në të cilin Qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur.*

Akti Normativ nr.15 datë 15.04.2020, pati si qëllim:

- a) *Të reflektojë reduktimin në masën 7 miliardë lekë, të zërave të shpenzimeve buxhetore, korente dhe kapitale, referuar kursimeve të evidentuara dhe atyre të pritshme për 2020.*
- b) *Të reflektojë rritjen në masën 7 miliardë lekë të fondit të dedikuar për paketën e dytë financiare në mbeshtetje të masave sociale Anti-Covid19.*
- c) *Të miratojë mbeshtetjen për biznesin në formën e instrumentit të Garancisë së re Sovrane në masën 15 miliardë lekë, e cila shkon për kompanitë që u gjenden përballë vështirësive, jo vetëm për pagesën e pagave të punonjësve, por edhe në nivel kapitali apo likuiditeti.*
- d) *Ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor.*

Nisur nga sa mësipër, në kushtet e situatës së vështirë dhe atipike socio-financiare të shkaktuar nga Pandemia Covid-19, pritshmëria për ecurinë e shpenzimeve buxhetore është ende në proces vlerësimi intensiv nga ana e strukturave përgjegjëse në MFE. Parashikimet kuantitative për impaktin negativ të COVID-19 në ekonomi, deri më tani, mbeten të rrethuara nga një marzh i lartë paqartësie.

Në cdo rast, nisur nga ngadalësimi i performancës së shpenzimeve buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, si pasojë e ngadalësimit të veprimtarisë së njësive të qeverisjes së përgjithshme, pritshmëritë janë për një realizim më të ulët të shpenzimeve normale të institucioneve buxhetore (krahasuar me trendin vjetor), të cilat në cdo rast (në linjë me dy AN e miratuara tashmë) do të ri-orientohen padiskutim drejt masave sociale dhe financiare anti-Covid19, në mbështetje të qytetarëve, bizneseve dhe rimëkëmbjes së sektorëve kyç të ekonomisë në tërësi, me objektiv primar përmirësimin gradual të treguesve makro-fiskal e buxhetorë dhe ruajtjen e qendrueshmerise fiskale.

IV. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë periudhës janar-mars 2020 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2019 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit. Huamarrja në tremujorin e parë është realizuar në linjë me buxhetin e vitit 2020² dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve. Nëpërmjet burimeve të huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues, menaxhimi i nevojave për likuiditet, si edhe financimin e deficitit të planifikuar për tremujorin e parë të vitit 2020. Gjatë këtij tremujori nevojat për huamarrje kanë shënuar një rritje të moderuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht duke reflektuar masat e ndërmarra në kaudër të reduktimit të riskut të rifinancimit që buron nga maturimi i Eurobond-it në tremujorin e fundit të vitit. Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 u menaxhua reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm, si edhe u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në drejtim të reduktimit të risqeve ndikim ka pasur realizimi i huamarrjes së re më së shumti nëpërmjet titujve afatgjatë me norma interesi fikse, duke mundësuar rritjen e peshës së këtyre titujve në portofolin e borxhit. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë tremujorit të parë të vitit 2020 është vijuar me praktikatat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it.

Për sa i përket zhvillimeve në tregun primar, kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 ka qenë e kënaqshme dhe ka mbuluar plotësisht nevojat e qeverisë për huamarrje të brendshme, përfshirë këtu edhe nevojat përgjatë muajit mars ku pandemia COVID-19 ishte shfaqur në Republikën e Shqipërisë.


Normat e interesit në tregun e titujve shtetërorë kanë shfaqur një tendencë rritëse përgjatë tremujorit të parë, pothuajse në të gjitha maturitetet e titujve. Megjithëse kjo rritje ka qenë brenda pritshmërive për vitin 2020, vlerësohet të ketë patur një përshpejtim të saj, kryesisht të ndikuar nga pasiguria në tregjet financiare për shkak të pandemisë COVID-19.

² Efektet që burojnë nga ndryshimet fiskale të krijuara nga pandemia COVID-19 nuk kanë pasur ndikim mbi planet e huamarrjes të tremujorit të parë të vitit 2020.

IV.1 Stoku i Borxhit Publik

Në fund të muajit mars 2020, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,162.4 miliard Lekë ose 66.7% e PBB . Në terma nominal, stoku i borxhit publik është rritur më rreth 49.8 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2019, nga të cilat 11.1 miliard Lekë i korrespondojnë rritjes së borxhit të brendshëm dhe 38.6 miliard Lekë borxhit të jashtëm. Rritja e stokut të borxhit të jashtëm i atribuohet kryesisht nënçmimit të monedhës vendase ndaj monedheve të tjera që kompozojnë portofolin e borxhit të jashtëm. Me përhapjen e pandemisë COVID-19 edhe në vendin tonë, tregu i këmbimit valutor pësoi luhatje të ndjeshme, si rrjedhojë, krahasuar me fundin e vitit 2019, monedha vendase u zhvlerësua me rreth 7.3% kundrejt monedhës Euro.


Grafiku 34: Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2016–Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm i qeverisë qendrore në raport me totalin e borxhit publik janë përkatësisht rreth 52.4% dhe 47.6%, duke shënuar një rritje të lehtë në drejtim të borxhit të jashtëm me 1.3 pp. Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se gjysmën e peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, eurobond), ndjekur nga huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve dhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore.

Grafiku 35: Përbërja e borxhit të qeverisjes qendrore në raport me totalin (2016-Mars 2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2020 portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të dominohet mbi 50% nga titujt shtetërorë të tregtuar në tregun vendas, në përputhje me objektivat strategjike për mbajtjen nën kontroll të riskut të kursit të këmbimit.


Grafiku 36: Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2016–Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Për sa i përket kompozimit të borxhit të brendshëm, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë titujt afatgjatë duke qëndruar në raporte pothuajse të njëjta me fundin e vitit 2019. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.


Grafiku 37: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror (2016-Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 50% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Ndërkohë, për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme (p.sh. Eurobond-i), peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë kreditë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Grafiku 38: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit & instrumenteve (2016-Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

IV.2 Menaxhimi i Borxhit

Huamarrja gjatë tremujorit të parë 2020 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2020 dhe në përputhje me objektivat strategjikë për reduktimin risqeve dhe zhvillimin e tregut të titujve. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues, menaxhimi i nevojave për likuiditet, si edhe financimi i deficitit të planifikuar për vitin 2020. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 94.5 miliard Lekë, nga të cilat 96.4% (ose 91.1 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 3.6% (ose 3.4 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Rreth 85.6 miliard Lekë shërbyen për rifinancimin e borxhit ekzistues, ndërsa pjesa tjetër për mbulimin e deficitit buxhetor të planifikuar.

Huamarrja e Brendshme

Gjatë periudhës janar-mars 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 91.1 miliard Lekë, nga të cilat 62.0 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe 29.1 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatgjatë. Rreth 88.2% e huamarrjes së brendshme ka shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër për të shërbyer nevojat buxhetore. Në linjë me objektivin për reduktimin e ekspozimit ndaj risqeve, huamarrja e re (*neto*) është siguruar në masën 65.2% nëpërmjet titujve afatgjatë.


Tabela 11: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto&neto (Janar-Mars 2020)

Lloji i Titullit	TM.I 2020			
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në % të totalit)
Tituj Afatshkurtër	62.0	58.2	3.7	34.8%
Bono Thesari në Lekë	62.0	58.2	3.7	34.8%
Bono Thesari në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Tituj Afatgjatë	29.1	22.1	7.0	65.2%
Obligacione 2 vjeçare	11.9	12.5	-0.6	-5.5%
Obligacione 3 vjeçare	4.3	0.0	4.3	39.6%
Obligacione 5 vjeçare	3.9	2.6	1.2	11.4%
Obligacione 7 vjeçare	5.1	7.0	-1.9	-17.4%
Obligacione 10 vjeçare	4.0		4.0	37.1%
Gjithsej Tituj Shtetërorë	91.1	80.3	10.8	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Krahasuar me tremujorin e vitit të kaluar, huamarrja e brendshme është rritur me rreth 2.3 miliard Lekë, kryesisht duke reflektuar masat e ndërmarra në kaudër të reduktimit të riskut të rifinancimit që buron nga maturimi i Eurobond-it në tremujorin e fundit të vitit. Për sa i përket raportit të huamarrjes së brendshme me të ardhurat tatimore vërehet një rritje e moderuar e këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, i ndikuar kryesisht nga rënia e nivelit të të ardhurave, si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe përqendrimi më i lartë i huamarrjes në tremujorin e parë, për t'i paraprirë risqeve të mundshme përsa i përket emetimit të Eurobond-it të planifikuar, si edhe sigurimit të likuiditetit të nevojshëm për të shërbyer detyrimet e borxhit.

Grafiku 39: Huamarrja e brendshme në raport me të ardhurat tatimore (TM. I 2016-TM. I 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Huamarrja e Huaj

Gjatë periudhës janar-mars të vitit 2020, huamarrja e huaj u realizua në nivelin 3.4 miliard Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, huamarrja e huaj është reduktuar me rreth 1.0 miliard Lekë. Pothuajse gjysma e huamarrjes së huaj bruto është realizuar në drejtim të sektorit të transportit ndjekur nga sektori i energjisë dhe ai i ujësjellës kanalizimeve.

Tabela 12: Huamarrja e huaj në terma bruto (TM. I 2019-TM. I 2020)


Huajamarrja e Huaj Bruto	TM. I 2019		TM. I 2020	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Kredi për financim projektsh	2.9	66.7%	3.4	100.0%
Energjia	0.2	4.1%	0.7	20.3%
Transporti	1.0	23.5%	1.7	49.1%
Ujësjellës Kanalizime	0.9	20.3%	0.7	20.2%
Infrastruktura Urbane	0.7	16.1%	0.1	3.0%
Të Tjera	0.1	2.7%	0.2	7.4%
Mbështetje buxhetore	1.5	33.3%	0.0	0.0%
Gjithsej Huamarrja e Huaj	4.4	100.0%	3.4	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Kostot

Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 462 milion Lekë më të ulëta, kryesisht si rezultat i rikompozimit të portofolit të borxhit me instrumenta me normë interesi më të ulët.


Grafiku 40: Interesat e borxhit shtetëror në vlerë absolute dhe relative, ndaj PBB dhe të ardhurave tatimore (TM. I 2016-TM. I 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Nga ana tjetër, megjithëse vazhdon të rritet pesha e borxhit afatgjatë, kosto mesatare e borxhit të brendshëm shtetëror është ulur nga 3.84% në fundin e vitit 2019 në 3.79% në mars 2020, duke reflektuar një përmirësim në raportin ndërmjet koston dhe risqeve.

Grafiku 41: Jetëgjatësia & kosto mesatare e portofolit të borxhit të brendshëm shtetëror (2016-Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Risqet

Gjatë periudhës janar-mars 2020, megjithëse në mënyrë të moderuar, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit shtetëror ka evoluar në drejtim të objektivave strategjike afatmesëm. Në këtë drejtim, ndikim pozitiv kanë pasur kryesisht ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm. Pesa e titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme janë ulur përkatësisht me 0.02 pp dhe 0.57 pp. Risku i refinancimit ka vijuar të reduktohet, pasi jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur me 13 ditë duke prekur nivelin e 800 ditëve në fund të muajit mars 2020, krahasuar me 787 ditë në fund të muajit dhjetor 2019. Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 50.87% në dhjetor 2019 në 50.75% në mars 2020.

Tabela 13: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2018–Maj 2020)

Treguesi i Riskut	2018	2019	Mars 2020
Koha mesatare deri në maturim (në ditë)	783	787	800
Borxh me normë fikse/Gjithsej borxhi i brendshëm	59.1%	62.0%	62.5%
Borxhi i rivlerësuar në një vit	54.3%	50.9%	50.8%
Koha mesatare në rifiksimit të normave (në vite)	2.06	2.11	2.16

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)


Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar-mars të vitit 2020 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje; ii) vijimi me projektin pilot për emetimin e obligacionit 5-vjeçar dhe 3-vjeçar referencë.

Ecuria e ankandëve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë periudhës janar-mars 2020 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 104.6 miliard Lekë, nga të cilat 69.7 miliard Lekë për bono thesari dhe 34.9 miliard Lekë për obligacione. Kërkesa gjatë këtij tremujori ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, megjithatë duke filluar nga muaji shkurt është verejtur një reduktim i kërkesës për tituj shtetërorë, ndikuar kryesisht nga pasiguria e krijuar në tregje nga pandemia COVID-19.

Grafiku 42: Raporti i mbulimit të ankandëve të titujve shtetërorë (Janar–Mars 2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Nga pikëpamja e investitorëve, baza e investitorëve, vijon të jetë e përqëndruar në mbi 60% tek sektori bankar duke e bërë portofolin e borxhit të brendshëm të ndjeshëm ndaj risqeve sistematike që mund të paraqesë ky sektor. Struktura e tregut primar të titujve ka vijuar të konsolidohet nëpërmjet strategjisë e cila synon emetimin e titujve referencë, si shtysë për zhvillimin e tregut sekondar në të ardhmen. Në këtë drejtim, gjatë tremujorit të parë është vijuar me emetimin e obligacioneve 3 dhe 5 vjeçare referencë.

Ecuria e normave të interesit

Gjatë tremujorit të parë 2020 normat e interesit në tregun e titujve shtetërorë kanë shfaqur një tendencë rritëse pothuajse në të gjitha maturitetet e titujve shtetërorë. Rritja e normave të interesit përgjatë vitit 2020 ka qënë brenda pritshmërive, por e përshpejtuar gjatë tremujorit të parë kryesisht nga pasiguria e tregjeve financiare për shkak të pandemisë COVID-19.

Grafiku 43: Norma mesatare e ponderuar e titujve shtetërorë³ (2018-Mars 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

IV.3 Pritshmëritë e Borxhit për vitin 2020

Nisur nga nevojat buxhetore në rritje, të krijuara nga masat e qeverisë në kuadër të menaxhimit të Pandemisë COVID-19, parashikimi me rënie i të ardhurave në buxhet, si edhe parashikimi në rënie i PBB-së, niveli i borxhit publik në raport me PBB parashikohet me rritje për fundin e vitit 2020. Gjatë periudhës së mbetur të vitit 2020, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, megjithëse nevojat në rritje për huamarrje e vështirësojnë procesin e realizimit të këtij objekti. Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër do të synohet kryesisht refinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit. Financimi i huaj do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit. Huamarrja e huaj pritet të realizohet kryesisht nëpërmjet instrumentit të Eurobond-it, si edhe nëpërmjet huave në formën e mbështetjes buxhetore, të cilat do të financojnë nevojat për financim në rritje të shkaktuara nga pandemia COVID-19 dhe reformat e ndermarra nga qeveria.

V. RREZIQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka iniciuar monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente.

³ I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.

Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontigjente. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të Buxhetit Afatmesëm. Përkatësisht vlerësohen dy kategori risqesh:

- *“Eksplícite”, Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.*
- *“Implicite”, kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.*

Tabela 14 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet <u>eksplicite</u>	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet <u>implicite</u> dhe detyrimet <u>kontigjente</u>	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Risqe të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 datë 20.01.2020 *“Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”*, ka vijuar monitorimi i risqeve kryesore fiskale/buxhetore nëpërmjet strukturës së Monitorimit të Risqeve Buxhetore. Kryesisht, raportimi në adresë të MFE u kanalizua përmes skeduleve kohore strikte dhe formateve standarde të miratuara, një proces tashmë i institucionalizuar për monitorimin e risqeve, krahas intensifikimit të punës në drejtim të rritjes së cilësisë së përpunimit, raportimit dhe publikimit të informacionit të grumbulluar, me synim final:

- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të performancës financiare të tre ndërmarrjeve shtetërore të sektorit të energjisë;
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë tremujore, të stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes qendrore dhe skedulit e parashikuar të shlyerjes;
- Monitorimin dhe raportimin periodik mbi bazë mujore, të performancës së kontratave konçesionare/PPP, me mbështetje buxhetore.

Mëposhtë jepet një tablo e vlerësimeve mbi disa nga tipologjitë e risqeve fiskale, si rezultat i monitorimit nga njësitë përgjegjëse në MFE, për periudhën Janar-Maj 2020:

V.1 Sektori Energjetik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke marr parasysh ndikimin e ndjeshëm fiskal dhe në ekonomi të këtij sektori kyç. Ky monitorim, i cili kryhet periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, sipas së cilit: “...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave...”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sesitive që e karakterizojnë. Në tabelat e mëposhtme jepet ecuria e treguesve kryesorë financiarë të sektorit energjetik 2020, krahasuar me periudhat e mëparshme.

Tabela 15: Të dhënat financiare për Sektorin Energjetik (në mijë Lekë)

	2018	2019	3 mujor 2020
Të ardhurat	86.358.496	73.435.148	18.511.715
Shpenzimet	69.387.337	79.135.838	21.592.891
Humbje/Fitim	16.971.159	(5.700.690)	(3.081.176)
Aktivët Afatshkurtra	123.932.674	129.381.757	129.600.128
Aktivët fikse	205.106.798	191.371.820	193.486.067
Total Aktive	329.039.473	320.753.577	323.086.195
Detyrimet afatshkurtra	157.705.753	189.587.399	186.545.553
Detyrimet afatgjata	80.097.567	63.244.851	66.316.762
Total Detyrime	237.803.320	252.832.250	252.862.315
Pasuria Neto	91.236.153	67.921.327	70.223.879

	3 mujor 2018	3 mujor 2019	3 mujor 2020
Të ardhurat	25.975.659	19.675.559	18.511.715
Shpenzimet	25.026.116	21.434.033	21.592.891
Humbje/Fitim	949.544	(1.758.474)	(3.081.176)
Aktivët Afatshkurtra	112.162.240	126.027.866	129.600.128
Aktivët fikse	201.442.896	205.968.459	193.486.067
Total Aktive	313.605.136	331.996.325	323.086.195
Detyrimet afatshkurtra	170.282.089	169.244.973	186.545.553
Detyrimet afatgjata	68.437.490	73.376.918	66.316.762
Total Detyrime	238.719.579	242.621.892	252.862.315
Kapital	74.885.557	89.374.433	70.223.879

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Në 3-mujorin e parë të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë vërehet se:

- Të ardhurat pësuan një rënie prej 1.2 miliard Lekë ose 5.9 përqind, ndërkohë që, shpenzimet janë rritur me 159 milion Lekë ose 0.7 përqind. Për pasojë:
 - ✓ *Rezultati financiar (fitim/humbje) për këtë tre mujor është negativ. Konkretisht sektori rezulton me humbje prej rreth 1.3 miliard Lekë.*
 - ✓ *Totali i Aktiveve ka pësuar rënie përkatësisht me 2.7 përqind dhe Detyrimet janë rritur me 4.2 përqind, duke sjellë për rrjedhojë uljen e zërit të kapitalit me 21.4 përqind.*
 - ✓ *Marzhi i fitimit, raporti korrent, kthimi mbi aktivet dhe kthimi mbi kapitalin kanë trend rënës, duke treguar një performancë jo të mirë financiare të sektorit në përgjithësi.*

Një rol të konsiderueshëm në rezultatin e sektorit ka Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. Për tre mujorin e vitit 2020, referuar të dhënave të raportuara nga OSHEE sh.a evidentohet:

- ✓ *Një nivel të ardhurash operative rreth 15 milion Lekë me një rënie rreth 2.1 përqind krahasuar me tre mujorin e vitit 2019.*
- ✓ *Rezultati (Fitim/Humbje) i periudhës tre mujore rezulton rreth 1 miliard Lekë humbje. Kjo situatë pritet të vazhdojë edhe në muajt në vijim duke konsideruar efektin që do të ketë periudha e pandemisë Covid-19 në ndryshimin e strukturës së konsumit të energjisë elektrike.*
- ✓ *Sipas buxhetit të vitit 2020 të OSHEE sh.a të ardhurat pritet të jenë rreth 54.6 miliard Lekë dhe rezultati i pritshëm vjetor të jetë me një fitim prej 3.7 miliard Lekë.*
- ✓ *Niveli i pritshëm i arkëtimeve për vitin 2020 është 97 përqind e shumës së faturuar dhe humbjet parashikohet të jenë 21 përqind.*

Sipas parashikimeve më të fundit të KESH sh.a dhe OSHEE sh.a ,deri në fund të vitit 2020 pritet që:

- ✓ *Energjia e parashikuar që do të sigurohet nga KESH sh.a për OSHEE sh.a do të jetë në nivelin e 3.95 GWh megjithëse sipa raporteve të OSHEE sh.a kjo sasi pritet që të reduktohet në 3.3 GWh.*
- ✓ *Importi i energjisë, sipas përlogaritjeve të OSHEE, do të jetë rreth 788 MWh me një çmim prej rreth 8.630 Lekë/MËh , me një kosto totale prej 6.8 miliard lekë*
- ✓ *Të ardhurat e parashikuara nga shitja e energjisë priten në masën 54.6 miliard lekë, ose 1% më të ulta se plani i në 2019 ose 5.4 miliard Lekë më të ulëta se të ardhurat faktike të vitit 2019 të cilat rezultuan 57.7 miliard Lekë.*

Kjo situatë mund të sjellë vështirësi financiare kryesisht për OSHEE sh.a, pasi këtë mungesë do të duhet ta përballojë me energji të siguruar në tregun e lirë të energjisë, me çmim shumë herë më të lartë se sa ai me të cilin e siguron nga KESH sh.a. Gjithashtu situata e krijuar pas gjendjes së emergjencës për fatkeqësinë natyrore të muajve të fundit pritet që ti shkaktojë një humbje prej rreth 1 miliard Lekë e cila mund të thellohet nëse periudha e rikthimit në gjendjen normale do të zgjasë më gjatë.

Kushtëzuar nga situata e pafavorshme hidrike e vitit 2019, situata financiare në të cilën gjendet kompania dhe sektori, si dhe periudha në të cilën po kalon vendi, MFE rekomandon marrjen e masave të nevojshme, kryesisht në drejtim të:

- Rivlerësimin të pozicionit financiar, duke konsideruar (përmes parashikimeve të qëndrueshme e realiste) zhvillimet e pritshme në prodhimin vendas të energjisë.
- Rishikimin në ulje i planit të investimeve për vitin 2020, kjo referuar Planit për Konsolidimin Financiar të Sektorit Publik Elektroenergjitik, dakordësuar me Bankën Botërore, ku OSHEE sh.a duhet të respektojë një nivel investimesh prej rreth 5 miliard lekë në vit, për tre vitet e ardhshme (ndërkohë që, investimet e OSHEE sh.a për vitin 2019 janë miratuar në nivelin 8.9 miliard LEK, të reja dhe në vazhdim).
- Marrjes së masave të nevojshme për menaxhimin optimal të likuiditeteve dhe reduktimin e kostove operative të OSHEE sh.a.

V.2 Detyrimet e prapambetura (qendrore)

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, MFE ka vijuar me monitorimin e stokut të detyrimeve të prapambetura, si në aspekt të krijimit të detyrimeve të reja dhe në aspekt të skedulimit të shlyerjes progresive të atyre ekzistuese. Ky monitorim kryhet mbi bazë tremujore dhe referuar të dhënave të raportuara nga ministritë e linjës për T1 të vitit 2020 vihet re se:


- Stoku total kumulativ (të mbartura+të reja) i detyrimeve të prapambetura, të regjistruara deri në Mars 2020,për njësitë e qeverisjes qendrore kap nivelin 6.53 miliard lekë.
- Ky stok rezulton rreth 20.4 përqind më i ulët ose 1.67 miliard lekë më pak, se niveli i tij i monitoruar deri në muajin Dhjetor 2019, që kapte vlerën 8.2 miliard lekë.
- Rreth 61.6 përqind e stokut të detyrimeve ose 4.03 miliard lekë janë detyrime që i referohen vendimeve gjyqësore.
- Pjesën më të madhe të stokut të detyrimeve e ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me rreth 1.7 miliard lekë ose 26.2 përqind e stokut total prej 6.53miliard lekë.

Tabela 16: Detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore deri në Mars 2020.

në milion lekë

NR	TOTALI I DETYRIMEVE MINISTRIA E LINJES	Total Detyrimet	Të mbartura	Total Detyrimet e	Total Detyrimet	Nga te cilat: (Vendime Gjyqësore)
		STOK		Reja Janar-Mars	STOK	
		deri në Dhjetor 2019		2020	deri Mars 2020	
		a	b	c	d=b+c	
		8.200,25	5.106,73	1.423,43	6.530,17	4.025,34
1	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	4.709,2	1.617,9	98,7	1.716,6	1.384,1
	<i>nga te cilat: Mirëmbajtja</i>	403,3	1,5	77,3	78,7	-
2	MINISTRIA E MBROJTJES	883,0	883,0	401,5	1.284,5	54,6
3	MINISTRIA E BRENDSHME	1.097,8	1.097,8	50,6	1.148,4	642,6
4	MINISTRIA E DREJTËSISË	-	-	-	-	-
5	MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	538,2	538,2	121,7	659,9	390,0
6	MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË	399,8	399,8	64,8	464,6	464,6
7	D.P.TATIMEVE (V.G.)rimbursim TVSH)*	80,1	80,1	648,3	728,4	728,4
8	MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	-	-	-	-	-
9	MINISTRIA E KULTURËS	3,9	1,7	-	1,7	0,7
10	MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	189,5	189,5	6,9	196,5	196,5
11	MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË	298,7	298,7	30,8	329,6	163,9
12	MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	-	-	-	-	-

Grafiku 44: Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore 2019 - Mars 2020 (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Tabela 17: Detyrimet e prapambetura të MIE, sipas zërave kryesorë (në milionë Lekë)

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	Te trashguara	Te reja	Total
Ndertim e Sistemim Rruge	2,03	-	2,03
Sinjalistikë Rrugore	-	-	-
Supervizion Punimesh	-	-	-
Vendime Gjyqësore	480,22	12,26	492,48
TVSH & Kosto Lokale	-	2,50	2,50
Mirembajtje	1,46	77,28	78,74
ARRSH	483,72	92,04	575,76
AKUM	243,93	4,35	248,29
Vendime Gjyqësore	889,37	2,28	891,65
Investime	0,87	-	0,87
APARATI	890,24	2,28	892,52
Total	1.617,90	98,67	1.716,57

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Në nivel tremujori, referuar të dhënave të raportuara nga ministritë e linjës, vihet re se:


- Detyrimet e reja të krijuara gjatë tremujorit Janar-Mars 2020, janë 1.4 miliard Lekë.
- Detyrime të prapambetura të shlyera gjatë Janar-Mars 2020, janë rreth 3.1 miliard Lekë.
- Pjesën më të madhe të detyrimeve të reja të krijuara në tre mujorin e parë të viti 2020 e zënë detyrimet e krijuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

V.2.1 Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë

Këto vendime kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me kështe të pagesës për përfituesit apo instrumentave të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore. Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e nivelit të detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore deri në Mars 2020, mbi bazë tremujore.

Grafiku 45: Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Kjo, përse kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

V.3 Koncesionet/PPP-të

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitet e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t’u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore. Referuar përgjegjësive specifike të njësive monitoruese respektive në MFE, të gjitha njësitet e qeverisjes qendrore, ndërmarrjet shtetërore dhe autoritetet kontraktuese janë të detyruara të paraqesin:

- Pranë Sektorit të Risqeve Fiskale në MFE:

- ✓ Raportin periodik të detyrimeve të prapambetura dhe detyrimeve të krijuara rishtazi në njësitet e qeverisjes qendrore;
- ✓ Raportin e detyrimeve të prapambetura të krijuara rishtazi për rimbursimin e TVSH-së;
- ✓ Skedulën e pagesave të detyrimeve të prapambetura;
- ✓ Ndërmarrjet shtetërore në sektorin e energjisë dërgojnë pasqyrat financiare tre mujore dhe ndërmarrjet e tjera shtetërore raportojnë lidhur me treguesit kryesorë financiarë sipas formateve të përcaktuara në udhëzimin e zbatimit të buxhetit 2020;
- ✓ Raportin mujor mbi ecurinë e performancës financiare dhe jo financiare (treguesit e performancës) për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore.

- Pranë Drejtorisë së Konçesioneve në MFE:
 - ✓ *Raportin mbi ecurinë e termave të kontratës për të gjitha kontratat koncesionare/PPP;*
 - ✓ *Raportin periodik të risqeve të përcaktuara në kontratë për të gjitha kontratat koncesionare/PPP.*
- Pranë ATRAKO-s në MFE:
 - ✓ *Kontratat e lidhura nga Autoritetet Kontraktore me dhe pa mbështetje buxhetore.*

Në fund të periudhës 5 mujore të vitit 2020, në nivel total rezultoi se, nga 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore:

- *8 kontrata koncesionare/PPP kanë pagesa faktike buxhetore, për periudhën 5 mujore,*
- *Për 5 kontrata nuk është kryer asnjë pagesë referuar periudhës 5 mujore.*

Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020 me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, sipas planit vjetor të ndryshuar me Aktin Normativ nr.15 datë 15.04.2020, në total janë rreth 7.58 miliardë lekë. Nga këto, rreth 2.88 miliardë lekë janë investime dhe rreth 4.7 miliardë lekë shpenzime korente. Plani vjetor sipas Aktit Normativ nr.15 rezulton rreth 4.44 miliard lekë më pak se plani fillestar vjetor i vitit 2020. Krahasuar me pagesat faktike të vitit 2019 të cilat arritën vlerën 13.7 miliard lekë, pagesat e planifikuara për vitin 2020 janë rreth 6.1 miliard lekë më të ulëta ose 44.7 përqind më pak. Pagesat faktike për periudhën 5 mujore të vitit 2020, në total rezultuan në rreth 3.54 miliardë lekë ose 46.7% e planit vjetor 2020, ndërkohë që në 5 mujorin e vitit 2019 këto pagesa arrinin nivelin 7.7 miliardë lekë ose 56% e planit vjetor 2019.

- *Duhet mbajtur parasysh fakti se, në pagesat e vitit 2019 përfshihen edhe pagesat për kontratën “Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese”, kontratë e cila ka përfunduar në vitin 2019.*

Pagesat e muajit Maj 2020 rezultuan në masën rreth 418.95 milion lekë ose rreth 43.9 milion lekë më pak se pagesat e muajit Prill. Pagesa më e lartë e realizuar në muajin Maj është pagesa prej rreth 130 milion lekë për kontratën e “Shërbimit të Skanimit në Dogana”, pagesë e cila përbën 31 përqind e totali të pagesave për muajin Maj dhe rreth 15.5 përqind të planit total vjetor, të ndryshuar, për këtë kontratë. Për periudhën 5 mujore, niveli më i lartë i pagesave është realizuar në muajin Shkurt me rreth 1.12 miliardë lekë, ku veçojmë pagesën prej 390 milion lekë për kontratën e MIE “Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë”, pagesë e cila përbën 48 përqind të planit vjetor 2020 për këtë kontratë.

Respektimi i rregullit fiskal për vitin 2020:

Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP për vitin 2020, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, përllogaritet në rreth 21.3 miliard lekë. Në nivel vjetor, pagesat e planifikuara për vitin 2020, për kontratat koncesionare/PPP, përbëjnë rreth 1.78 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, duke respektuar në këtë mënyrë rregullin fiskal prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës. Në nivel 5-mujor, pagesat neto të realizuara të kontratave koncesionare/PPP, përbëjnë vetëm 0.83 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426.27 miliard lekë.

Tabela 18: Koncesionet/PPT-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë lekë)

Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2018	Fakt 2019	Plan Vjetor 2020, i ndryshuar	Total SM	% realizimit
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2014	2020	06220	Investime 231	601,429	631,317	224,270	144,932	64.6%
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investime 231	752,771	752,770	190,000		
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investime 231	1,355,108	1,505,822			
	3	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2030	04520	Investime 231		3,910,860	1,662,000	630,000	37.9%
		Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje	2018	2031	04520	Investime 231		3,780,000	1,520,000	630,000	41.4%
		Oponencë Teknike	2020	2020	04520	Investime 230			2,000		
		Supervizion	2018	2022	04520	Investime 231		130,860	140,000		
	4	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime 231	308,183	570,643	810,259	406,682	50.2%
		Defektet e Fshehura			04520	Investime 231	249,939	268,273			
		Supervizioni	2017	2022	04520	Investime 231	58,244	59,393	70,000	39,670	56.7%
		Subvencion	2019	2032	04520	Investime 231		242,977	740,259	367,013	49.6%
	5	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriku - Dukat			04520	Investime 231					
	6	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren			04520	Investime 231					
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korente 602	1,525,579	1,509,659	840,896	643,976	76.6%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Koncesioni/PPP Kontrolli bazë i popullsisë (check up)	2015	2025	07220	Korente 604	876,083	876,083	426,083	320,140	75.1%
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjike, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjike, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjike)	2016	2026	07330	Korente 604	1,625,581	2,163,282	1,310,000	512,226	39.1%
	3	Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	07330	Korente 604	738,911	804,388	733,000	300,733	41.0%
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korente 604			400,000		
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës	2018	2025	09120	Investime 231					
MIE / Bashkia Tiranë	1	Inceneratori i Tiranës	2017	2047	06260	Korente 602	977,000	977,125	980,000	580,000	59.2%
					06220	Korente 602	224,000	477,125	480,000	80,000	16.7%
							753,000	500,000	500,000	500,000	100.0%
13	TOTAL						8,760,645	13,701,949	7,576,508	3,538,688	46.7%
Totali i të Ardhurave Tatimore							419,334,130	426,270,680			
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							3.27%	1.78%			

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

V.4 Detyrime të tjera Kontigjente

V.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likuidimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit.

- Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/4 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi të shpërblimit:
 - ✓ *Vendimet me detyrim financiar mbi 10.000 EUR, implikojnë nxjerrjen e VKM-ve respektive për ekzekutimin e tyre.*
 - ✓ *Vendimet me detyrim financiar deri në 10.000 EUR, ekzekutohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.*

Per periudhen janar-qershor 2020, rezulton se në MFE nuk ka ardhur asnjë projektvendim lidhur me pagesë të vendimeve të GJEDNJ-së, me detyrim financiar mbi 10.000 EUR dhe as vendime për ekzekutim nën këtë vlerë. Rrjedhimisht, nga fillimi i vitit 2020 e deri më tani, nga MFE nuk është kryer ndonjë pagesë për likuidim të vendimeve të GJEDNJ-së.

V.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT

Ato kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet ‘shteti shqiptar’ apo ‘qeveria shqiptare’, këto vendime likujdohen përmes buxhetit të MFE dhe/ose Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja. MFE, në vazhdimësi dhe me këmbëngulje, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit. Për periudhën janar-qershor 2020, nga institucionet buxhetore është raportuar se nuk janë kryer pagesa për vendime Arbitrazi. Detyrimi total i akumuluar për Arbitrazhet Ndërkombëtare, rezulton në rreth 109.5milion EUR.

Tabela 19: Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)

MINISTRIA E LINJËS	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Detyrim i mbetur
MIE	4.188.308,51 Euro dhe 3.183.263 lekë Arbitrazhi për çështjen me palë paditëse "J&P AVAX" S.A kundër ish Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE)	4,214,402
	2.495.166 Euro detyrimi i MIE në favor të shoqërisë SAFA sh.p.k për projektin e ndërtimit të rrugës "Tiranë-Elbasan" + 876.940,02 Euro interes i shumës së dhënë nga gjykata + 171.231,86 Euro interes për tarifat e arbitrazhit	3,543,338
MFE (Shteti Shqiptar)	ICSID Case no ARB/17/6	1,000,000
	99.487.000 EUR dhe 111.579,989 EUR Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	99,598,580
	Kosto administrative dhe ankimi për Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	311,413
	Porti i Karpen "HFW" LLC (Detyrim i përbashkët me MIE)*	217,563
	TIA shpk (Detyrim i përbashkët me MIE)*	50,000
MBZHR	750.000 EUR shpenzimet për avokatët dhe 19.500 euro kostot fillestare të arbitrazhit, Arbitrazhi për çështjen Valeria Italia S.r.l	550,000
	Total	109,485,296

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2020)

VI. KONKLUZIONE DHE PROPOZIME

Parashikimi i rritjes ekonomike, apo më saktë recensionit ekonomik për vitin 2020, si dhe të gjithë variablave të tjerë makroekonomikë, do të jetë subjekt rishikimesh në vijimësi të qartësisë të dinamikës së situatës. Parashikimet kuantitative për impaktin negativ të COVID-19 në ekonomi, deri më tani, mbeten të rrethuara nga një marzh i lartë paqartësie. Pritet që impaktin më të lartë negativ ta kenë aktivitetet ekonomike që lidhen me sektorët e turizmit, transportit dhe tregtisë. Po gjithashtu pritet të preken konsiderueshëm edhe sektorët e industrisë përpunuese, industrisë nxjerrëse, shërbimeve të tjera dhe ndërtimit. Mundet që njëkohësisht disa sektorë të tjerë të kenë një impakt neto pozitiv, si p.sh. sektori i bujqësisë, kryesisht për shkak të efektit të zëvendësimit të mallrave të importit me ato të prodhuara në vend. Ndërkohë nga pikëpamja e kërkesës agregate, impakti më i lartë negativ pritet në eksportet totale, sidomos ato të shërbimeve, dhe në konsumin final, por gjithashtu edhe investimet totale pritet të kenë një impakt negativ, ndonëse më të zbutur se sa dy komponentët e parë. Ndërsa, turrja në të njëjtën kohë e importeve, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve, pritet të zbusë në një masë të caktuar efektin neto negativ në rritjen reale të PBB..

Zërat e të ardhurave buxhetore, që administrohen nga DPT dhe DPD, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, bazuar në performancën e 5 mujorit Janar-Maj 2020 si dhe në analizën e faktorëve që mund të impaktojnë realizimin e të ardhurave tatimore dhe doganore në 7 mujorin në vijim të vitit 2020, pritet të realizohen në nivelin 83,3% krahasuar me buxhetin fillestar 2020. Pra, parashikohet deficit në të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat prej -19,6% ose -64 miliard leke dhe në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore prej -8,73% ose -9 miliard lekë. Ndër faktorët kryesorë të cilët do të ndikojnë në realizimin e pritshëm të të ardhurave deri në fund të vitit 2020, janë:

- ✓ *Efektet në ekonomi nga Pandemia e Covid-19 do të jenë një nga faktorët kryesorë ndikues në mungesën e performancës së të ardhurave, për shkak të ndikimit direkt në uljen e qarkullimit dhe të konsumit, duke reduktuar të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin, Tatimin mbi të Ardhurat Personale, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Taksat, Kontributet etj.*
- ✓ *Çmimi i mineraleve kryesisht naftes por edhe ulja e kursit të kembimit të monedhave të huaja kundrejt lekut, kanë ndikuar dhe do ndikojnë në reduktimin e bazes së llogaritjes së detyrimeve tatimore për mallrat e importit.*
- ✓ *Shtyrja e pagesave të kesteve të tatimit mbi fitimin për vitin 2020 për shume industri do reduktoje të ardhurat në këtë ze.*
- ✓ *Efektet negative mbi ekonominë e vendit të situatave konfliktuale politike. Kjo situatë reflektohet në sjelljen e tatimpaguesve dhe nivelin e zbatimit vullnetar të ligjit nga ana e tyre.*

Pritshmëria për ecurinë e shpenzimeve buxhetore, në kushtet e situatës së vështirë dhe atipike socio-financiare të shkaktuar nga Pandemia Covid-19, është ende në proces vlerësimi intensiv nga MFE. Në cdo rast, nisur nga ngadalësimi i performancës së shpenzimeve buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, si pasojë e ngadalësimit të veprimtarisë së njërive të qeverisjes së përgjithshme, pritshmëritë janë për një realizim më të ulët të shpenzimeve normale të institucioneve buxhetore (krahasuar me trendin vjetor), të cilat në cdo rast (në linjë me dy AN e miratuara tashmë) do të ri-orientohen përkrahje drejt masave sociale dhe financiare anti-Covid19, në mbështetje të qytetarëve, bizneseve dhe rimëkëmbjes së sektorëve kyç të ekonomisë në tërësi, me objektiv primar përmirësimin gradual të treguesve makro-fiskal e buxhetorë dhe ruajtjen e qendrueshmerise fiskale.

Niveli i borxhit publik në raport me PBB parashikohet me rritje për fundin e vitit 2020. Kjo, nisur nga nevojat buxhetore në rritje të krijuara nga masat e qeverisë në kuadër të menaxhimit të Pandemisë COVID19, parashikimi në rënie i të ardhurave si dhe parashikimi në rënie i PBB. Gjatë periudhës së mbetur të vitit 2020, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, megjithëse nevojat në rritje për huamarrje e vështirësojnë procesin e realizimit të këtij objektiv

Në përfundim, nën dritën e analizës së mësipërme mbi ecurinë 5-mujore dhe pritshmëritë deri në fund të vitit fiskal 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjykon se vlerësimi i performancës 7-mujore të ecurisë së treguesve të konsoliduar makro-fiskal dhe buxhetorë, si të të ardhurave ashtu edhe të shpenzimeve, do të jetë vendimtar në drejtim të angazhimit për një rishikim eventual të ligjit të buxhetit të vitit 2020.

VII. SHTOJCAT

VI.1 Ecuria e detajuar e treguesve makroekonomikë gjatë janar-maj 2020⁴

Sektori real

Bazuar në statistikat dhe informacionin më të fundit të disponueshëm, rezulton se ekonomia është prekur nga pandemia Covid-19, e cila u përhap në fillim të muajit Mars në Shqipëri dhe më 11 Mars Qeveria vendosi kufizime lëvizshmërie, të cilat impaktojnë indikatorët ekonomik.

Tendencat e punësimit dhe papunësisë, sipas vlerësimeve të INSTAT për tremujorin e parë 2020, tregojnë vlera të qëndrueshme pranë mesatareve pozitive të viteve të fundit, ku ende nuk janë pasqyruar efektet e pandemisë. Përgjatë 3mujorit të parë 2020 punësimi vijoi trendin pozitiv të rritjes së tij, të rezultuar edhe përgjatë vitit 2019. Për 3mujorin e parë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë për grup-moshën 15 vjeç e lart regjistroi vlerën 11.4%, ndërsa për grupmoshën 15-64 vjeç shkalla zyrtare e papunësisë ishte 11.9%. Krahasuar me 3mujorin e mëparshëm (T4-2019), shkalla e papunësisë pësoi rritje prej 0.28 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me të njëjtin 3mujor të një viti më parë (T1-2019), shkalla e papunësisë u ul me 0.67 pikë përqindje. Numri i të punësuarve për 3mujorin e parë 2020 u rrit me 0.74% në terma vjetor për grup-moshën 15-64 vjeç. Trendin pozitiv e ka mbajtur edhe shkalla e punësimit duke arritur vlerën 61.4% për grupmoshën 15-64 vjeç, duke qëndruar rreth mesatares më të lartë në dhjetë vitet e fundit. Krahasuar me 3mujorin e mëparshëm ajo pësoi rënie me 0.2 pikë përqindje.

Një tjetër tregues i rëndësishëm që jep sinjale mbi rritjen ekonomike është treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) që në përputhje me metodologjinë, rezultatet e vrojttimeve të besimit për 3mujorin e parë të vitit 2020 i takojnë informacionit të marrë në periudhën 1-10 Mars, para se

⁴ Analiza e zhvillimeve ekonomike në këtë seksion, bazohet në statistikat/informacionin më të fundit zyrtar të disponueshëm, në momentin e hartimit të këtij raporti.

Pandemia COVID-19 të prekte Shqipërinë dhe Qeveria të shpallte masat parandaluese ndaj përhapjes së saj. Për këtë arsye, treguesit e besimit, e më në veçanti në sektorin e shërbimeve, nuk reflektojnë ndikimin negativ të Pandemisë në ekonomi. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi nivelin 103.3 në T1-2020 duke pësuar një rritje prej 8.5 pikësh nga tremujori i kaluar dhe një rënie me 2.1 pikë përqindje në krahasim me T1-2019. Niveli aktual i TNE-së qëndron 3.3 pikë mbi mesataren afatgjatë dhe rreth 0.1 pikë përqindje nën mesataren e 6 viteve të fundit. Rritja e nivelit të TNE-së i atribuohet vetëm përmirësimit të besimit në sektorin e shërbimeve. Besimi në sektorin e tregtisë rezultoi pothuajse i njëjtë me një tremujor më parë, ndërkohë që besimi në sektorët e industrisë, ndërtimit dhe besimi konsumator, shënoi rënie.

Treguesi i besimit në sektorin e industrisë (TBI) shënoi nivelin -4.8 në T1-2020 (-3.4 pikë përqindje më pak krahasuar me T1-2019), duke pësuar një rënie tremujore prej 3.1 pikë përqindje. Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit (TBN) shënoi nivelin -30 në T1-2020 (9 pikë përqindje më pak krahasuar me T1-2019), duke pësuar një rënie tremujore prej 0.5 pikë përqindje. Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) shënoi nivelin 12.4 në T1-2020 (6.4 pikë përqindje më shumë krahasuar me T1-2019), duke pësuar një rritje tremujore me rreth 16.1 pikë përqindje. Treguesi i besimit të tregtisë në T1-2020 ishte në nivelin -8.5, duke pësuar një rënie vjetore prej 3.4 pikë përqindje. Treguesi i besimit të konsumatorëve (TBK) shënoi nivelin -15.1 në T1-2020 (5.8 pikë përqindje më pak krahasuar me T1-2019) duke pësuar rënie tremujore me 1.5 pikë përqindje.

Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për periudhën janar - maj 2020 shënuan rënie prej -19.4% krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu vetëm për muajin maj 2020 eksportet shënuan rënie prej -22.7% në krahasim më muajin maj 2019. Në maj 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 21 mld lekë, ndërsa në pesëmujorin e parë të vitit 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 102 mld lekë, duke u ulur me 19.4 %, krahasuar me një vit më parë. Rënia vjetore e eksporteve prej 22.7% këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -8.6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -8.0 pikë përqindje etj. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +2.6 pikë përqindje. Zhvillimet sipas kategorive kryesore të mallrave të eksportit, si dhe kontributi i tyre në totalin e eksporteve, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 20: Rritja e eksportit të mallrave, sipas kategorive kryesore.

Rritja e eksporteve	Janar - Maj 2020 / 2019		Maj 2020 / 2019	
	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %) mujore
Ushqime, pije, duhan	3.5	0.4	19.4	2.6
Minerale, lëndë djegëse, en. elektrike	-21.7	-3.4	-48.3	-8.6
Produkte kimike dhe plastike	-6.3	-0.1	-19.0	-0.5
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-17.4	-0.1	-36.9	-0.3
Prodhime druri dhe letre	-16.4	-0.5	-32.9	-1.0
Tekstile dhe këpucë	-24.9	-10.1	-21.2	-8.0
Materiale ndërtimi dhe metale	-31.8	-5.1	-33.9	-5.4
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	2.4	0.2	-13.9	-0.8
Të tjera	-17.0	-0.5	-25.5	-0.8
Gjithsej	-19.4	-19.4	-22.7	-22.7

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të eksporteve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë.

Grafiku 46: Rritja mujore e totalit të eksporteve, në përqindje.




Importet e mallrave për periudhën janar – maj 2020 shënuan rënie prej -17.1% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për muajin maj 2020 importet shënuan rënie vjetore prej -24.2% në krahasim me muajin maj 2019. Në maj 2020 importet e mallrave arritën vlerën 45 mld lekë, ndërsa në pesëmujorin e parë të vitit 2020 importet e mallrave arritën vlerën 219 mld lekë, duke u ulur me 17.1%, krahasuar me një vit më parë. Rënia vjetore e importeve prej 24.2%, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6.5 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -5.1 pikë përqindje etj. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +0.03 pikë përqindje. Zhvillimet sipas kategorive kryesore të mallrave të importit, si dhe kontributi i tyre në totalin e importeve, paraqiten në tabelën e mëposhtme

Tabela 21: Rritja e importit të mallrave, sipas kategorive kryesore.

Rritja e importeve	Janar - Maj 2020 / 2019		Maj 2020 / 2019	
	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %) mujore
Ushqime, pije, duhan	2.4	0.4	-3.8	-0.6
Minerale, lëndë djegëse, en. elektrike	-37.6	-4.8	-54.9	-6.5
Produkte kimike dhe plastike	-3.3	-0.4	0.2	0.0
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-37.2	-1.1	-41.8	-1.4
Prodhime druri dhe letre	-8.6	-0.3	-11.4	-0.5
Tekstile dhe këpucë	-28.7	-3.9	-33.5	-4.8
Materiale ndërtimi dhe metale	-11.7	-1.5	-29.9	-4.1
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-22.3	-4.7	-25.1	-5.1
Të tjera	-20.4	-0.7	-34.3	-1.3
Gjithsej	-17.1	-17.1	-24.2	-24.2

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet rritja mujore e totalit të importeve në përqindje, kundrejt të njëjtit muaj të një viti më parë.

Grafiku 47: Rritja mujore e totalit të importeve, në përqindje.



Këto zhvillime në tregtinë e jashtme janë reflektuar dhe tek deficitin tregtar. Gjatë periudhës janar-maj 2020, bilanci tregtar u përmirësua me rreth 14.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, ndërsa vetëm për muajin maj 2020 bilanci tregtar u përmirësua me 25.6% krahasuar me muajin

maj 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 23 mld lekë, ndërsa në pesëmuajorin e parë 2020, deficiti tregtar arriti vlerën rreth 117 mld lekë, duke u ulur me 14.9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019. Në tabelën e mëposhtme paraqitet bilanci tregtar për pesëmuajorët ndër vite (2016-2020).


Tabela 22: Bilanci tregtar, sipas kategorive kryesore.

Bilanci tregtar për muajin Maj 2016-2020 (në milion Lekë)					
	05 M_16	05 M_17	05 M_18	05 M_19	05 M_20
Ushqime, pije, duhan	-29,620	-30,118	-30,228	-28,921	-29,472
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	-3,680	-383	-243	-13,776	-5,463
Produkte kimike dhe plastike	-30,266	-33,685	-33,281	-32,294	-31,323
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-5,817	-6,391	-6,876	-6,704	-3,998
Prodhime druri dhe letre	-5,650	-5,920	-6,099	-5,900	-5,702
Tekstile dhe këpucë	12,208	12,815	16,538	15,505	13,054
Materiale ndërtimi dhe metale	-20,515	-13,290	-7,584	-12,843	-15,444
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-42,785	-44,095	-49,921	-46,669	-34,076
Të tjera	-5,191	-6,708	-6,260	-5,864	-4,538
Gjithsej	-131,317	-127,776	-123,954	-137,465	-116,961

Sektori monetar

Në muajin maj 2020 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte **+2.1%**. Ndërsa një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte **+1.5%**. Inflacioni mesatar për periudhën janar – maj 2020 ishte **+1.8%**. Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e çmimeve për tre vitet e fundit:

Grafiku 48: Ndryshimi vjetor i Inflacionit, në përqindje



Burimi: INSTAT, Qershor 2020

Përgjatë kësaj periudhe, nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm e ka pasur zëri i ushqimeve dhe pije jo alkoolike. Në tabelën e mëposhtme mund të vihen re kontributet dhe rritjet respektive në çmime për çdo grup mallrash për muajin maj 2020.

Tabela 23: Rritja vjetore e çmimeve, në përqindje


Rritja vjetore e çmimeve (maj '20/ maj '19) dhe kontributi në inflacionin e përgjithshëm		
	Rritja (në %)	Kontributi në inflacion (në pikë %)
Ushqime	4.9	1.81
Pije alkoolike dhe duhan	0.6	0.02
Veshje dhe këpucë	-0.7	-0.02
Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji	1.4	0.29
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1.9	0.11
Shëndeti	-0.6	-0.02
Transport	-3.7	-0.23
Komunikim	0.4	0.01
Argëtim dhe kulturë	2.7	0.07
Shërbimi arsimor	0.2	0.01
Hotele, kafene dhe restorante	0.7	0.03
Mallra dhe shërbime të ndryshme	0.3	0.01
Inflacioni i përgjithshëm	2.1	2.1

Burimi: INSTAT, Qershor 2020

Rezultatet e Vrojtitimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e parë të vitit 2020 tregojnë se standardet e kredisë janë shtrënguar si në kreditë dhënë bizneseve për financimin e investimeve apo mbulimin e nevojave për likuiditet, ashtu edhe në ato akorduar individëve me qëllim blerjen e banesave apo financimin e konsumit. Bankat raportuan për një shtrëngim të standardeve për kredinë dhënë bizneseve gjatë tremujorit të parë të 2020 në nivelin -2.4%, krahasuar nga një lehtësim në nivelin 6.1% në tremujorin e katërt të vitit 2019. Ndërkohë, bankat raportuan për një shtrëngim të standardeve për kredinë drejt individëve gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 në nivelin -12.4%, krahasuar me një lehtësim në nivelin 4.9% të shënuar në tremujorin e katërt të vitit 2019. Kërkesa për kredi e bizneseve në tremujorin e parë të vitit 2020 është raportuar më e ulët si në segmentin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Gjithashtu, edhe kërkesa e individëve për kredi ka rezultuar në rënie në të dyja segmentet, si për kredinë konsumatore, ashtu edhe për kredinë hipotekore. Për bizneset, bankat raportuan se përgjatë tremujorit të parë të vitit 2020 kërkesa për kredi e SME-ve dhe korporatave u zvogëlua përkatësisht me -33.6% dhe me -26.8%. Për individët, bankat raportuan se përgjatë tremujorit të parë kërkesa për kredi për shtëpi shënoi një rënie prej -55.2%, nga një rënie prej -13% të shënuar në tremujorin e katërt të vitit 2019. Ndërkohë, për kredinë e individëve për konsum u raportua një rënie prej -56.9%, nga niveli prej -16.1% që u shënuar në tremujorin e mëparshëm.

Referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit prill të vitit 2020 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 4.3% krahasuar me prillin e vitit 2019. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 5.1%, ndërsa ai në valutë është rritur me 3.7% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2019. Në Prill 2020 rezulton se rreth 46.3% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 53.7% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj. Stoku total i depozitave vetëm për muajin Prill 2020 shënoi rënie me 30.0 miliardë Lekë kundrejt muajit paraardhës (Mars 2020). Stoku total i depozitave të bizneseve në muajin Prill të vitit 2020 shënoi rënie prej -0.2% krahasuar me Prillin e vitit 2019, ndërsa stoku total i depozitave të individëve ka shënuar rritje prej 4.4% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Grafiku 49: Ecuria e stokut të depozitave 2019-2020, në përqindje



Referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit prill të vitit 2020, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 5.9%, krahasuar me muajin prill të vitit 2019. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.5%, ndërsa ai në valutë rritje prej 3.4%, krahasuar me muajin prill të vitit të kaluar. Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin prill 2020 shënoi një rritje me 5.2%. Kredia vetëm për bizneset *private* jo-financiare u rrit me 6.4%, duke kontribuar pozitivisht me 2.2 pikë përqindje në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa, stoku i kredive akorduar bizneseve *publike* jo-financiare për muajin prill të vitit 2020 ka shënuar rënie me 12.8%, krahasuar me prillin e vitit 2019, me kontribut negativ prej 0.5 pikë përqindje. Në prill 2020 rezulton se rreth 51.4% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 48.6% përbëhet nga kreditë në valutë.

Tabela 24: Ecuria e kredisë për bizneset dhe individët, në përqindje

Rritja vjetore e stokut të kredisë (në %)								
Treguesit e kredisë	2019				2020			
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Janar	Shkurt	Mars	Prill
Stoku total i kredisë	-2.6	-1.5	-0.2	-0.1	6.0	6.8	9.2	5.9
Stoku i kredisë për biznesin	-2.7	-1.3	0.2	0.4	4.2	5.2	8.6	6.4
Stoku i kredisë për individët	3.7	4.4	4.7	4.5	6.6	6.7	8.4	6.4

Gjatë muajit prill të vitit 2020, sasia e re e kredisë së dhënë nga sistemi bankar në Lek shënoi rritje me 95.5% kundrejt muajit paraardhës (mars) dhe një rritje me 1.5% kundrejt të njëjtimit muaj të një viti më parë (prill 2019). Ndërkohë, sasia e re e kredisë së dhënë në Euro u rrit me 12.5% krahasuar me një muaj më parë (mars 2020), dhe ra me 28%, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë (prill 2019). Niveli i kredive me probleme ndaj totalit të kredive në fund të muajit prill 2020 arriti në 8.28%.

Tabela 25: Ecuria e kredive të këqija, në përqindje

2019												2020			
Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill
11.34	11.41	11.38	11.46	11.37	11.23	11.19	11.00	10.61	10.17	9.53	8.37	8.30	8.18	8.21	8.28

Sa i takon ecurisë së normave të interesit vihet re:

- ✓ *Për depozitat në Lekë* - Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave (duke përfshirë të gjitha maturimet) për prillin 2020 shënoi vlerën 0.6%, duke rënë me 0.18 p.p krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe duke rënë me 0.06 p.p krahasuar me muajin paraardhës. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12 mujore u zvogëluar me 0.03 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe nuk pati ndryshim në krahasim me një muaj më parë..

- ✓ *Për depozitat në US (\$) – Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave shënoi vlerën 0.23%, ose 0.18 p.p. më pak krahasuar me një vit më parë dhe 0.21 p.p më pak krahasuar me një muaj më parë. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12 mujore ka shënuar rënie prej 0.26 p.p.krahasuar me një vit më parë dhe një rënie me 0.3p.p krahasuar me një muaj më parë.*
- ✓ *Për depozitat në EUR (€) - Norma mesatare e interesit për totalin e depozitave shënoi vlerën 0.15%, duke u rritur me 0.03 p.p krahasuar me një vit më parë dhe duke u rritur me 0.06 p.p krahasuar me një muaj më parë. Ndërkohë, norma e interesit për depozitën 12 mujore u rrit me 0.14 p.p krahasuar me një vit më parë dhe pati rritje me 0.12 krahasuar me muajin paraardhës.*
- ✓ *Për kreditë në Lekë - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive (duke përfshirë të gjitha maturimet) për prillin 2020 shënoi vlerën 5.92%, ose 0.45 p.p. më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 0.62 p.p. më pak se muaji paraardhës. Ndërkohë, norma e interesit për kreditimin mbi 5 vjeçarë ka shënuar rritje prej 0.37 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe u rrit me 0.18 p.p krahasuar me muajin mars 2020..*
- ✓ *Për kreditë në US (\$) - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive shënoi vlerën 4.93%, duke shënuar rritje me 0.81 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe një rënie me 1.94 p.p krahasuar me muajin paraardhës.*
- ✓ *Për kreditë në EUR (€) - Norma mesatare e interesit për totalin e kredive për prillin 2020 shënoi vlerën 4.07%, ose 0.31 p.p. më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe ra me 0.09 p.p. krahasuar me një muaj më parë. Ndërkohë, norma e interesit për kreditimin mbi 5 vjeçar ka shënuar rënie prej 0.56 p.p. krahasuar me një vit më parë dhe një rënie me 0.22 p.p. krahasuar me muajin mars 2020.*

Gjatë muajit maj 2020, kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros arriti 123.9 lekë/euro duke pësuar rënie në vlerë me 1.19% krahasuar me një muaj më parë, dhe rritje me 0.75% krahasuar me një vit më parë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin maj arriti në 113.8 lekë/dollar amerikan duke shënuar rënie me 1.41% krahasuar me një muaj më parë, dhe një rritje me 3.49% krahasuar me një vit më parë.

Tabela 26: Ecuria e kursit të këmbimit 2015-2020

Kursi zyrtar i këmbimit										
Mesatare vjetore për periudhën 2015-2019, dhe mesatare mujore për periudhën Janar-Maj 2020										
Periudha kohore	2015	2016	2017	2018	2019	2020				
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj
USD	126.0	124.1	119.1	108.0	109.9	110.1	111.9	112.1	115.4	113.8
EUR	139.7	137.4	134.2	127.6	123.0	122.1	122.1	124.3	125.4	123.9

VI.2 Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2020

Buxheti i vitit 2020, ka financuar 131 programe buxhetore si edhe buxhetin e 61 bashkive dhe 12 qarqeve. Realizimi i buxhetit për 5 mujorin e vitit 2020 për ministrinë dhe disa nga institucionet qendrore kryesore, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 27: Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës, 4M I 2020

Institucionet	2020 Plani Fillestar	2020 Plani i Rishikuar	2020 Fakti 5 Mujor	Total Fakt/Plan Vjetor 2020	Shpenzime korrente Fakt/Plan 2020	Shpenzime kapitale Fakt/Plan 2020
Presidenca	252,300	235,600	66,926	28%	29%	0%
Kuvendi	1,341,160	1,287,660	391,601	30%	31%	30%
Kryeministria	591,000	578,660	178,299	31%	42%	0%
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	11,112,000	10,559,600	1,653,369	16%	25%	10%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	40,858,630	37,604,630	13,843,930	37%	41%	36%
Ministria e Financave dhe Ekonomise	59,857,139	74,213,394	33,938,725	46%	46%	28%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	41,979,763	41,328,005	15,361,163	37%	38%	21%
Ministria e Kultures	2,256,204	2,467,331	727,420	29%	32%	26%
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	62,969,940	66,522,111	26,289,789	40%	41%	11%
Ministria e Drejtesise	10,846,390	10,659,615	3,467,477	33%	32%	39%
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	3,416,380	3,292,380	1,202,647	37%	38%	12%
Ministria e Brendshme	20,545,648	20,747,540	7,528,380	36%	37%	33%
Ministria e Mbrojtjes	24,108,845	23,225,805	7,597,798	33%	35%	20%
Akademia e Shkencave	106,000	98,130	27,753	28%	29%	0%
Kontrolli Larte i Shtetit	444,036	420,636	152,264	36%	37%	26%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,241,030	2,458,850	939,615	38%	36%	42%
Prokuroria e Pergjithshme	2,308,800	2,301,600	800,218	35%	37%	0%
Keshilli i Larte Gjyqesor	3,409,150	3,304,650	1,015,355	31%	33%	0%
Gjykata Kushtetuese	147,000	128,350	36,855	29%	29%	0%
Keshilli i Larte i Prokurorise	152,324	143,674	34,184	24%	27%	0%
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	14,898,000	22,513,503	2,336,565	10%	-	10%
Institucionet e sistemit te drejtesise	484,600	470,900	152,181	32%	33%	1%
Institucione te tjera Qeveritare	6,519,020	6,997,380	3,482,346	50%	43%	64%

SHËNDËTËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2020, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 28: Shëndetësia dhe mbrojtja sociale

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4/M 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
	Ministria e Shëndet.dhe Mbrojtjes Sociale (Total)	61,927,226	2,122,000	20,789,951	210,541	34	10
	Financimi i huaj (total)		1,110,000		171,833		16
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,476,946	204,128	266,717	522	18	0.3
2	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,187,122	526,276	2,887,713	20,327	40	5
	Financimi i huaj		158,000		21,397		14
3.	Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	23,353,627	1,306,014	6,810,710	189,692	29	15
	Financimi i huaj		852,000		142,554		17
4.	Shërbime të Shëndetit Publik	3,140,291	23,500	828,677	0	26	0
5	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	360,200	23,182	50,140	0	14	0

6.	Përkujdesi Social	25,372,940	37,700	9,532,447	0	38	0
	Financimi i huaj		100,000		7,882		8
7	Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik	1,036,100	1,200	413,548	0	40	0

Në programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor”** janë realizuar objektivat e:

- Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve për persona që do të kryejnë kontrollin mjekësor bazë periodik.
- Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve për të gjithë popullatën e siguruar ose jo.
- Plotësim i qendrave shëndetësore me infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e sistemit të informacionit.

Këto objektiva janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve, si më poshtë:

- ✓ “Mbulimi me kujdesin parësor”, janë realizuar vizita tek mjeku i familjes, gjatë kësaj periudhe, 2.066.445 pacientë me një kosto faktike rreth 807 milionë lekë.
- ✓ “Kryerja e Chek-Up”, ku gjatë 4/Mujorit të parë të vitit 2020 kanë kryer chek-up rreth 100 mijë pacientë me një kosto faktike rreth 352 milionë lekë.
- ✓ “Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes”, me një kosto faktike prej 1,728 milionë lekë për 343.266 pacientë

Në programin **“Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor”** janë realizuar objektivat e:

- Mbulimit të popullatës me kujdes mjekësor spitalor;
- Rritja e efektshmërisë në dhënien e shërbimit spitalor nëpërmjet uljes së kohës së pritjes së pacientëve që kanë nevojë për shërbim spitalor të 10 paketave të shërbimeve në spitalet publike e private të financuara nga FSDKSH.
- Rritja e sigurisë së shërbimit të rregjistrimit, kontrollit të barnave e materialeve mjekësore;
- Rritja e aksesit të pacientëve për shërbimin e dializës, nëpërmjet ofrimit në qendra të reja;
- Plotësimin e nevojave të spitaleve me infrastrukturë ndërtimore,

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4/mujorin e parë të vitit 2020, është si më poshtë:

- ✓ “Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale”, ku janë shtruar 82.790 pacientë me një kosto faktike prej rreth 5,667 milionë lekë.
- ✓ “Pacientë të trajtuar nga paketat spitalore”, ku janë trajtuar 2.239 pacientë, me një kosto faktike, prej 245 milion lekë;
- ✓ “Trajtimi i pacientëve në spitalet psikiatrike”, ku janë trajtuar 425 pacientë, me një kosto faktike, prej 200 milionë lekë, nga 1450 pacientë të planifikuar me një kosto 714 milion lekë.
- ✓ “Pacientë të trajtuar me dializë”, ku janë kryer 64,290 seanca me një kosto faktike prej 725 milionë lekë, duke rritur aksesin e pacientëve për shërbimin e dializës nëpërmjet ofrimit në 5 qendra të reja.

Në programin **“Shërbime të Shëndetit Publik”** janë realizuar objektivat e:

- Sigurimit të qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinare, për vaksinat e kalendarit të vaksinimit;
- Reduktimit të numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit;

- Rritjes së përputhshmërisë ligjore dhe ndëshkimit të parregullsive të evidentuara nëpërmjet sigurimit të kryerjes së inspektive shëndetësore;
- Depistimit të grave për kancerin e gjirit.

Këto objektiva, për 4/mujorin e parë të vitit 2020, janë realizuar nëpërmjet realizimit të produkteve, performanca e të cilave paraqitet si më poshtë:

- ✓ “Inspektive të kryera nga inspektoriatet” është realizuar me një kosto faktike prej 63 milion lekë dhe janë kryer 4.711 inspektive.
- ✓ “Blerja dhe monitorimi i vaksinave” është realizuar me një kosto faktike prej rreth 124 milion lekë dhe janë vaksinuar rreth 66.495 fëmijë.
- ✓ “Monitorimi i situatave epidemiologjike”, është realizuar me një kosto faktike prej 583 milion lekë dhe janë kryer rreth 866 kontrolle për të monitoruar agjentët mjedisore për ujrat, ambientin, ushqyerjen, shëndetin në punë, duke respektuar standartet e BE-se.
- ✓ “Depistimi i grave për kancerin e gjirit”, ku janë depistuar 951 gra me një kosto faktike prej 2,5 milionë lekë.

Në programin “**Kujdesit Social**” janë realizuar objektivat e:

- Reformimit të programit të përkujdesit social në tre shtylla kryesore të tij NE, PAK dhe Shërbimet
- Përfshirja e barabartë sociale dhe ekonomike e burrave, grave, fëmijëve dhe grupeve të marginalizuara.
- Zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për mbrojtjen sociale;
- Rritjes së kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4/mujorin e parë të vitit 2020, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ “Familje dhe individë në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike”, është realizuar me një kosto faktike prej 1,729 milion lekë për 60.970 familje përfituese.
- ✓ “Persona me aftësi të kufizuar përfitues nga programi i aftësisë së kufizuar” është realizuar me një kosto faktike prej 6,808 milion lekë për 167.674 persona përfitues.
- ✓ “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike”, është realizuar me një kosto faktike prej 252 milionë lekë për 750 persona.
- ✓ “Shperblimi i lindjes” ku kanë përfituar 30.000 bebe me një kosto faktike prej 720 mln lekë.

ARSIMI

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2020, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për 4/ mujorin e parë të vitit 2020, paraqitet si më poshtë

Tabela 29: Arsimi

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4/M I 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	38,624,830	2,605,000	11,856,245	341,999	31	13
	Financimi i huaj (total)		216,000		38,215		18
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	704,350	22,000	166,945	0	24	0
2.	Arsimi Bazë	21,724,720	1,117,000	6,869,031	118,259	32	11
3..	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	6,264,543	842,000	1,934,636	159,094	31	19
4.	Arsimi i Universitar	9,397,969	430,000	2,805,695	40,608	30	9
	Financimi i huaj		100,000		10,431		10
5.	Fonde për Shkencën	313,147	100,000	22,246	17,964	7	18
	Financimi i huaj		100,000		6,261		6
6.	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	220,100	94,000	57,693	6,074	26	7
	Financimi i huaj		16,000		0		0

Në programin “Arsimi Bazë” objektivat e të cilit janë:

- Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar;
- Sigurimi i kushteve dhe garantimi i kushteve për çdo fëmijë/ nxënë, për të ndjekur arsimin parashkollor, si dhe arsimin 9-vjeçar.
- Zhvillimi dhe implementimi i kurrikulës së re në arsimin 9-vjeçar.
- Rritja e viteve të shkollimit.
- Rritja e autonomisë së shkollave.
- Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në Arsimin Bazë.
- Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në Arsimin Bazë.
- Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimit të mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e Arsimin Bazë.
- Shtrirja e shërbimit të punonjësve social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4/Mujorin e parë 2020, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ Trajtimin me një kompensim shtese mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar, ku përveç pagës, punonjësve mësimorë, që punojnë larg vendbanimit, përfitojnë një kompensim në masën, 2.700 lekë në muaj deri në 5 km larg vendbanimit dhe 6.000 lekë në muaj mbi 5 km larg vendbanimit, duke përfituar rreth 9.000 punonjës mësimorë;
- ✓ Ofrimi i shërbimit të transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin për rreth 38.660 mijë nxënësve/mësues që kanë vendbanim mbi 2 km nga shkolla, për transportin për fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor dhe edukatorëve të

tyre, si dhe transportin e mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë.

- ✓ Ofrimi i teksteve shkollore falas në përdorim për të gjithë nxënësit nga klasa e parë në klasën e gjashtë, si dhe nxënës të 16 kategorive sociale nga klasa e shtatë në klasën e nëntë duke siguruar rreth 205 mijë nxënës të arsimit bazë për blerjen e teksteve shkollore, realizuar me rreth 500 milion lekë.
- ✓ Ofrimi i kuotës ushqimore, bursa me fonde të buxhetit të shtetit, për të mbuluar shpenzimet për kuotë ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta, për rreth 1.400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë.
- ✓ Mbi arsimin gjithpërfshirës, do të sigurohet arsim cilësor dhe gjithpërfshirës më synim që 100% e femijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin bazë. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuar, ndaj vitit paraardhës. Rritja e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në rreth 940 mësues.

Në programin **“Arsimi Mesëm i Përgjithshëm”** objektivat e të cilit janë:

- Nxënës që rregjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë pasi përfundojnë arsimin bazë.
- Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve të klasës së 11 në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.
- Realizimi i Maturës Shtetërore 2020, realizimi i testimit "Mësues për Shqipërinë", në formë elektronikë.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm, rehabilitimi i klasave në gjimnaze në zonat urbane, shtimi i klasave të reja në zonat urbane, pajisja me mjete didaktike për Fizikë-Kimi-Biologji të shkollave të mesme, pajisja e shkollave me klasa mësimore inteligjente/ digjitale, si dhe pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për 4/Mujorin e parë 2020, është realizuar, si më poshtë:

- ✓ Në vitin shkollor 2019-2020, afro 96,1 % e nxënësve që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm. Në këtë vit shkollor marrin shërbim arsimor në arsimin e mesëm 90,000 nxënës,.
- ✓ Në procesin e kualifikimit për vitin 2020, morën pjesë mësues të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm.
- ✓ Plotësimi i paketës kurrikulare sipas qasjes me bazë kompetencat në arsimin e mesëm të lartë ka të bëjë me hartimin e udhëzuesve kurrikularë lëndorë. Këta udhëzues janë hartuar sipas profileve lëndore në ndihmë të mësuesve të arsimit të mesëm të lartë me shembuj konkretë dhe praktikë për zbatimin e kurikulës në klasat 10-12.
- ✓ U hartuan dhe u miratuan formularët A1 dhe A1/Z dhe u shpallën në fqen e MASR-së
- ✓ U riaktivizua portali U-Albania
- ✓ U përcaktuan dhe u miratuan qendrat se ku do të zhvilloheshin provimet për Maturën Shtetërore 2020.

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si më poshtë:

Tabela 30 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4M 2020		% e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	340,800	25,000	75,502		22.2	0.0
2.	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,199,634	603,122	274,993	74,159	22.9	12.3
3.	Mbështetje për Peshkimin	110,000	629,935	28,101		25.5	0.0
4.	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	649,889	2,820,800	194,571	75,250	29.9	2.7
5.	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,120,500	2,540,443	80,769	162,925	7.2	6.4
6.	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	481,477	16,000	125,850	-	26.1	-
7.	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	22,000	0	25		0.1	-
	TOTAL	3,924,300	6,635,300	779,810	312,334	19.9	4.7

Në programin e **“Zhvillimit rural duke mbështetur prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun”**, janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 243.7 milionë lekë, të tilla si:

- Hartimi i bazës ligjore për masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për 4 mujorin e parë të vitit 2020, VKM nr.100 datë 5.2.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2020” si dhe udhëzimi me bashkë firmosje midis MBZHR dhe MFE me Nr.3, datë 24.2.2020 “Për kriteret procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.” si dhe ndryshimet përkatëse në to;
- Hapja e fushatës promovuese për aplikimet në masat kombëtare;
- Vazhdimi i procedurave të vlerësimit dhe kontrollit të aplikimeve në kuadër të thirrjes së dytë të programit IPARD;
- Hartimi urdhrat të Ministrisë për listën e produkteve STG, si dhe udhëzimi për formën e regjistrat, detyrim i Ligjit për “Skemat e Cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;
- Certifikimi dhe testimi i rreth 736 777 fara dhe fidanë;
- Degustimi i rreth 10 mostrave të cigareve;
- Fillimi i procedurave për rikonstruksionin e zyrave të AZHBR, blerjen e pajisjeve;
- Fillimi i procesit të identifikimit dhe verifikimit në vend të sipërfaqeve me vresht dhe ullishte;
- Fillimi i procesit të disbursimit të fondeve nga Projekti Mjedisor.

Në programin **“Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”**, janë realizuar për 4 mujorin e parë produkte me një kosto faktike prej 349.2 milionë lekë, ku ndër to përmendim:

- Blerja e vaksina dhe kryerja e vaksinimit për 90 000 krerë për sëmundjen e plasjes nga 930 000 të planifikuara për vitin 2020;

- Kryerja e 43 800 kontrolleve për kafshë të shëndetshme nga 173 000 të planifikuara, për vitin 2020, akoma nuk ka filluar procesi i gjurmimit të kafshëve;
- Janë realizuar 9 000 analiza në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale nga 55 250 të planifikuara për vitin 2020;
- Janë dëmshpërblyer fermerë për 10 krerë të ngordhur nga 470 të planifikuar;
- Janë kryer 30 125 inspektime në fushën e sigurisë ushqimore nga 96 000 të planifikuar.

Në programin “**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**”, janë parashikuar disa produkte dhe janë realizuar një pjesë e tyre me një kosto totale prej 296.8 milionë lekë, ndër to përmendim:

- Sipërfaqe kulluese me rrjetin kryesor të pastruar janë punuar rreth 8000 hektar;
- Rreth 12 000 hektar sipërfaqe ujitëse me rrjet kryesor ujitës të mirëmbajtur;
- Mirëmbajtje për funksionimin normal të 27 hidroforëve për kullimin e rreth 70 000 hektarëve;
- Në lidhje me projektin e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes, të financuar nga Banka Botërore, nga 6 skema ujitëse, vazhdojnë punimet në 5 skemat ujitëse (Tregtan 3 dhe 2, Sllanicë, Leminot, Dega e Lushnjës, Dega e Çukasit) dhe pritet të fillojnë punimet në skemën ujitëse me rezervuarin e Janjarit.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Performanca e treguesve buxhetorë për 10 programet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 31: Infrastruktura dhe Energjia

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4-mujori 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Transporti Rrugor	1,502,291	13,299,800	435,395	6,059,763	29%	46%
	Financimi i huaj		6,108,132		1,883,708		31%
2.	Mbështetje për Energjinë	87,900	228,000	5,495	6,184	6%	3%
	Financimi i huaj		1,760,000		710,213		40%
3.	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	373,805	3,969,800	18,304	323,940	5%	8%
	Financimi i huaj		4,411,411		905,482		21%
4.	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	500,000	1,162,272	411,275	145,994	82%	13%
	Financimi i huaj		630,000				0%
5.	Transporti Hekurudhor	423,756	165,700	136,961	8,110	32%	5%
	Financimi i huaj		1,200,000				0%
6.	Transporti Detar	108,173	45,000	27,556	1,003	25%	2%
7.	Transporti Ajror	20,200	35,000	2,731		14%	0%
8.	Planifikimi Urban	191,184	78,000	166,738	23,463	87%	30%
	Financimi i huaj		220,000		1,149		1%

9.	Mbeshtetje per Burimet natyrore	148,365	57,000	44,814	18,195	30%	32%
10.	Mbeshtetje per Industrine	281,795	85,000	78,984	11,356	28%	13%

Për programin **“Transporti Rrugor”** gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020 janë realizuar fondet në masën 40%, duke u realizuar kështu edhe qëllimi i këtij programi, i cili është *“Forcimi dhe integrimi me rrjetin rajonal dhe TEN-T. Dyfishimin e numrit të lidhjeve nderkombetare toksore me Kosoven, Maqedonine, Greqine dhe Malin e Zi (v.2020 ndaj v.2007), që do të dyfishonte transportin nderkombetar të udhetareve dhe të mallrave. Perfundimin e Korridoreve me të gjitha korsite dhe parametrat teknike deri në fund të vitit 2020, duke përfshirë arterie strategjike si: autostrada Adriatiko-Joniane në kuader të procesit të Berlinit dhe Konektivitetit; Korridori 8; Korridori Durrës-Morinë”* Ky qëllim është realizuar nëpërmjet dy objektivave, specifikisht (i) Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar dhe (ii) Sistemim asfaltim e riveshje për rrugë të rrjetit kombëtar.

Realizimi i produkteve për secilen nga objektivat paraqitet si më poshtë:

Për objektivin *“Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar”*, janë realizuar fondet në masën 3,158 milionë lekë ose rreth 46 % e fondeve vjetore të planifikuara. Disa nga produktet kryesore që kanë kontribuar në realizimin e objektivit, janë:

- Tipi i rrugës A2’ 2x2 me trotuar dhe ndriçim, për të cilin fondet e planifikuara për vitin buxhetorparaqiten të realizuar përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020 në masën prej 412 milionë lekë. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces paraqiten si më poshtë:
 - *“Përfundim i punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit”;*
 - *“Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1, Loti 2, Loti 3”;*
 - *“Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3”;*
 - *“Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2”;*
- Rruga tip B1’ me dy kors, për të cilën janë realizuar fondet në masën prej 1,735 milionë lekë ose 44% ndaj totalit të planifikuar për vitin 2020. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet me ritme të parashikuara janë:
 - *“Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6”;*
 - *“Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3”;*
- Për rrugën tip C2 me dy kors, janë realizuar fondet përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020 në masën prej 1,012 milionë lekë ose 16% e fondeve të planifikuara. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet normalisht dhe që janë në proces janë:
 - *“Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1”*
 - *“Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije”*
 - *Stabilizim i rrëshqitjeve në segmentin rrugor Milot - Rrëshen, rruga e vjetër;*
 - *Ndërtim i tombinos dhe kanalit në km 6+500 të aksit rrugor Tiranë - Elbasan (aksi i vjetër);*
 - *Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme në aksin Lin - Pogradec.*

Për objektivin “Sistemim asfaltim e riveshje për rrugë të rrjetit kombëtar”, janë realizuar fonde në masën 354 milionë lekë. Disa nga objektet më të rëndësishme, të cilët kanë kontribuar në realizimin e objektivit të programit, paraqiten si më poshtë:

- *Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1, vazhdimi;*
- *Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendror, Loti 2;*
- *Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;*
- *Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3, vazhdimi;*
- *Punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë (bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore).*
- *Përmirësim i sigurisë rrugore në segmentet me rrezik të lartë të rrjetit rrugor kombëtar;*
- *Eliminim i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar.*

Në programin “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime” është realizuar qëllimi i programit i cili synon: *“Shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare.”* Produktet e realizuara, me synim realizimin e qëllimit, paraqiten si më poshtë:

- Realizimi i 23,424 ml linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë, shoqëruar me një kosto prej 184 milionë lekë.
- U realizua rreth 848ml rikonstruksion Ujësjellësi ose 3.5% e fondeve të planifikuara për produktin.
- U realizua rreth 365ml rikonstruksion KUZ-i, ose 12% e fondeve të planifikuara për produktin “Rikonstruksion KUZ”.

Niveli i ulët i realizimit lidhet me produktin *“Ndërmarrje të ujesjellës kanalizimeve të subvencionuara”*, i cili paraqitet pa realizim përgjatë 4 Mujorit të parë të vitit 2020. Aryeja e mosrealizimit lidhet me:

- *AKUM-ja, bazuar në vlerësimin e performancës të sh.a. UK-ve, brenda muajit shtator të çdo viti i propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, metodologjinë dhe skemën që duhet të zbatohet për ndarjen e fondeve, për përqindjen që shkon për mbulimin e "Kostos direkte të operimit" (në rastet e shoqërive me vlerë negative të diferencës së të ardhurave të faturuara -KDO) dhe përqindjen e fondit të përgjithshëm që do të shkojë për nxitjen e performancës së shoqërive, pavarësisht diferencës së kostos. Përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020 nuk është sjellë detajimi për shpërndarjen e fondeve nga ana e MIE.*

Në programin “Mbështetje për Burimet Natyrore” është realizuar qëllimi i programit lidhur me *“Mbështetjen e politikave në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, që synojnë jo vetëm zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, por dhe rritjen e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore”*. Për realizimin e këtij objektivi janë realizuar fondet në masën 18 milionë lekë ose 32% e fondeve vjetore të planifikuara. Produktet të cilët kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit renditen sa më poshtë:

- Janë përditësuar 725 të dhëna të lejeve minerare gjeohapsinor, me kosto prej 1.3 milionë lekë.
- U realizua mbikqyrja e 360 burimeve të shfrytëzimit minerare, metalore dhe jo metalore, me kosto prej 3 milionë lekë.
- Është realizuar promovimi i minerave të rinj dhe kërkimeve teknologjike e mjedisore.
- Është kryer monitorimi i Fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura
- Është realizuar projekti i studimit mbi zonimin minerar dhe hartimit të planit vjetor dhe 3-vjecar minerar.
- U realizua projekti mbi “Raportin vjetor të gjëndjes mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji”

Me programin “Menaxhimi i Mbetjeve urbane” është realizuar qëllimi i programit i cili është “Përmirësimi i infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane”. Qëllimi është arritur nëpërmjet realizimit të dy objektivave të këtij programi. Lidhur me objektivin “Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet ndërtimit të lëndfilleve rajonale”, për të cilin janë realizuar fondet në masën 557 milionë lekë apo 24% të fondeve të planifikuara për vitin 2020. Produktet e realizuara paraqiten si më poshtë:

- Sipërfaqe landfilli e ndërtuar në Qarkun e Vlorës
- Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan (Inceneratori i Elbasanit) i ndërtuar

TURIZMI DHE MJEDISI

Performanca e treguesve buxhetorë për tre programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si më poshtë:

Tabela 32: TURIZMI DHE MJEDISI

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4M 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Mbrojtja e Mjedisit	459,820	198,288	117,065	3,626	18%	2%
	Financimi i huaj		290,000		70,459		24%
2.	Administrimi i Pyjeve	400,100	89,812	115,558	-	29%	-
	Financimi i huaj		50,000		24,702		49%
3.	Zhvillimi i Turizmit	356,830	265,500	186,622	28	52%	-
	Financimi i huaj		50,000		-		-

Në programin “Mbrojtja e Mjedisit” për 4 Mujorin e parë të vitit 2020, fondet janë realizuar në nivelin 26 % kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

- Produkti “Inspektime të kryera”, është realizuar në masën 71% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.

- Produkti “*Raporte monitorimi*” është realizuar në masën 11% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.
- Produkti “*Dosje te shqyrtuara per perftimin e lejeve te mjedisit*” është realizuar në masën 15% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.

Në programin “Administrimi i Pyjeve” për 4 Mujorin e parë të vitit 2020, fondet janë realizuar në nivelin 29 % kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Produktet, të cilët kanë kontribuar në realizimin e qëllimit të programit paraqiten si vijon:

- Produkti “*Raporte monitorimi në Zonat e Mbrojtura*”, është realizuar në masën 18% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.
- Produkti “*Objekte te administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura*” është realizuar në masën 8% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.
- Produkti “*Inspektime te kryera*” është realizuar në masën 66% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.

Në programin “Zhvillimi i Turizmit” për 4 Mujorin e parë të vitit 2020, fondet janë realizuar në nivelin 52% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Produktet të cilët kanë kontribuar në realizimin e objektivave të këtij programi paraqiten si vijon:

- Produkti “*Monitorime të kryera përgjatë gjithë vijës bregdetare*”, është realizuar në masën 68% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.
- Produkti “*Turizëm i promovuar*” është realizuar në masën 18% përgjatë 4 mujorit, kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2020.

DREJTËSIA

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet në Ministrinë Drejtësisë, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 33: Drejtësia

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	352,966	325,300	82,317	103,609	23.3	31.9
2.	Publikimet Zyrtare	51,653	5,000	12,595	0	24.4	0.0
3.	Mjekësia Ligjore	76,140	10,000	19,230	0	25.3	0.0
4.	Shërbimi për Çështjet e Birësimit	14,450	2,000	2,301	0	15.9	0.0
5.	Agjencia e trajtimit të pronave	3,736,496	1,000	54,840	0	1.5	0.0
6.	Ndihma juridike	51,800		4,789		9.2	
7.	Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	146,550		38,897		26.5	
8.	Sistemi i Burgjeve	5,369,416	320,374	1,626,058	156,720	30.3	48.9
9.	Shërbimi i Provës	195,970	500	42,051	0	21.5	0.0
	TOTAL	9,995,441	664,174	1,883,078	260,329	18.8	39.2

Në programin “**Sistemi i burgjeve**” për 4 mujorin e parë të vitit 2020 janë realizuar produkte, me një kosto faktike 1,782,778 mijë lekë, përmendim:

për programin e Sistemit të Burgjeve janë realizuar produktet për të matur performancë e Sistemit të Burgjeve, si dhe projekte që shërbejnë për përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar, disa prej tyre kanë realizim faktik sipas pritshmërisë, si më poshtë:

- Janë trajtuar 592 raste të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor;
- Rezultojnë 4,812 burra të dënuar që po vuajnë dënimin në IEVP;
- Janë të trajtuara në kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit 74 të dënuara femra, ky numër ka pësuar ulje edhe për shkak të amnistisë së ndodhur në 4 mujorin e parë të vitit;
- Janë trajtuar 20 të mitur të dënuar të cilët vuajnë dënimin në ambientet të përshtatshme për vuajtjen e dënimit.

Në programin “Agjencia e Trajtimit të Pronave” janë realizuar produkte me kosto faktike prej 54,840 mijë lekë, ndër produktet përmendim:

- Shpërndarja e fondit fizik dhe financiar” nga 1,000 subjekte të planifikuara për realizim vjetor janë realizuar 175. Ecuria e aplikimeve është e ulët për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 janë mbyllur të gjitha sportelet për shërbime dhe funksionojnë vetëm online.
- “Trajtimi me vendim i kërkesave për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim” nga 410 vendime janë trajtuar 52. Gjithashtu lidhur me realizimin e këtij qëllimi janë kryer 12 aplikime të reja, 57 vlerësime dhe 75 verifikime.
- “Mbrojtja e interesave të ATP në proceset gjyqësore” nga 1, 600 të planifikuara janë ndjekur 451 raste gjyqësore që kanë të bëjnë me çështje njohje të drejte pronësie apo që kanë të bëjnë me vlerësimin e pronës së njohur për kompensim.
- “Shpërndarja e fondit të ALUIZNIT” nga 1,104 numër subjektësh të planifikuara për realizim janë trajtuar vetëm 255 prej tyre, gjatë kësaj kohe ka pasur një ngadalësim të procesit jo vetëm prej situatës së pandemisë por edhe si rezultat i një ngërçi ligjor me Agjencinë e Kadastrës lidhur me tarifat e marrjes së shërbimit nga ana e ATP-së.

INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për 4 mujorin e parë 2020 për institucionet e Sistemit të Drejtësisë , paraqiten si më poshtë:

Tabela 34: Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit/Institucionit	Plani 2020		Fakti 4 mujori I		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1	Veprimtaria e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë / Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë	79,350	7,000	2,322	0	2.9%	0.0%
2	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit / Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	186,350	4,000	58,238	0	31.3%	0.0%
3	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar / Kolegji i Posaçëm i Apelit	125,150	2,000	38,717	0	30.9%	0.0%
4	Veprimtaria e komisionerit publik / Komisionerët Publikë	66,050	1,000	20,771	0	31.4%	0.0%

Në lidhje me disa nga treguesit e performancës për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit KPK, tregues i performancës është numri i dosjeve të shortuara, numri i dosjeve të shqyruara dhe

vendime të marra. Konkretisht raportohet se prej fillimit të veprimtarisë, janë shortuar 478 subjekte rivlerësimi, janë marrë në shqyrtim 300 dosje dhe në vitin 2020 deri në fund të 4 mujorit janë rivlerësuar me vendime 28 subjekte.

Nga ana e Komisionerëve Publikë për vitin 2020 produkti i këtij institucioni “Çështje të njoftuara nga KPK dhe shqyrtuar nga KP brenda afateve ligjore”, nga 130 të planifikuara për vitin 2020, deri në fund të 4 mujorit janë realizuar në sasi 26 çështje.

FINANCAT, EKONOMIA, PUNËSIMI DHE ARSIMI PROFESIONAL

Shpenzimet e planifikuara për vitin 2020 dhe ato faktike për 4 mujorin e parë, si dhe realizimi në përqindje për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për disa nga programet kryesore, paraqiten si më poshtë:

Tabela 35: Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimiti Profesional

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4 mujor		Përqindja e realizimit	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	580,350	193,000	173,337	61,957	29.9%	32.1%
Financimi i huaj		200,000		261,517		130.8%
Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,533,400	417,000	534,556	0	21.1%	0.0%
Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	2,577,800	173,220	1,040,542	1,074	40.4%	0.6%
Financimi i huaj		84,100		1,289		1.5%
Sigurimi Shoqëror	45,839,014		16,233,000		35.4%	
Tregu i Punës	14,067,800	30,000	4,972,109	0	35.3%	0.0%
Arsimi i Mesëm Profesional	1,984,400	475,469	468,754	209,167	23.6%	44.0%
Financimi i huaj		703,900		501.61		0.1%
Strehimi	2,309,000	320,000	913,381	5,639	39.6%	1.8%

Sipas të dhënave, realizimi faktik i shpenzimeve korentë paraqitet në mesataren e periudhës, ndërsa investimet pritet të kenë realizim më të lartë në periudhën në vazhdim.

Sa i përket programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore**”, objektivi i këtij programi është *Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, aplikimi i metodave dhe sistemeve të reja, modernizimi, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore si rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë. Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut, përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore, mbledhja efikase dhe efektive e borxhit.* Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2020, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon: “Tatimpagues të asistuar” janë asistuar 159 461 tatimpagues ose 97 përqind e parashikimit, “Inspektime, hetime tatimore”, janë realizuar për 4-mujorin 6 825 inspektime ose 15 përqind e planifikimit vjetor 2020.

Sa i përket programit “**Menaxhimi i të Ardhurave Doganore**” objektivi kryesor i këtij programi është *Krijimi i lehtësirave për operatorët ekonomikë nëpërmjet lehtësimit dhe përshpejtimit të procedurave doganore.* Për arritjen e këtij objektivi, për 4-mujorin 2020, janë realizuar produktet

me të dhënat si vijon: “Deklarata doganore të proçesuara” irealizuar në sasi në masën 146 801 deklarata.

Në programin “**Tregu i Punës**” në kuadër të rishikimit të buxhetit nëpërmjet dy Akteve Normative, Aktit Normativ Nr.6, datë 21.3.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” dhe Aktit Normativ Nr.15, datë 15.4.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020” të ndryshuar u mundësua alokimi i fondeve të nevojshme buxhetore për përballimin të situatës emergjente të krijuar nga Pandemia COVID-19, specifikisht me *Vendimin nr. 254, datë 27.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shpallur si pasojë e Covid-19”* u mundësua paketa e parë e ndihmës në produktin “Pagat e biznesit per masat anti COVID-19” u alokuan 4 700 milionë lekë dhe në produktin “Persona të trajtuar me pagesë papunësie” rreth 118.4 milionë lekë. Me *Vendimin nr. 305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”* u mundësua paketa e dytë e ndihmës në produktin “Pagat e biznesit per masat anti COVID-19” ku u alokuan 7 040 milionë lekë, të cilat deri në fund të 4 mujorit u disbursuan në masën 4 555 milionë lekë.

Në programin “**Strehimi**” realizimi i 4-mujorit të parë për vitin 2020 mund të rendisim sa mëposhtë:

- *Subvencionimi i interesave për kreditë ekzistuese është realizuar në vlerën 34,057 mijë lekë. Si pasojë e situatës emergjente të shkaktuar nga Covid-19, pagesat e interesave të kredive për muajin Prill, nuk u paguan pasi nuk ishin pjesë e listës së pagesave prioritare të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë nr.14, datë 24.03.2020 “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.*
- *Subvencionim qiraje në tregun e lirë, sipas Ligjit nr.22/2018, për 4-mujorin e parë, janë alokuar fondet prej 75,000 mijë lekë për 18 bashki të vendit. Kërkesa totale e bashkive ishte në vlerën 91,360 mijë lekë dhe fondi i parashikuar për vitin 2020, për këtë program, u shpërnda duke u bazuar në pikën 7 të udhëzimit nr.31, datë 18.11.2020 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”. Realizimi faktik, për 4-mujorin e parë është në masën 27,812 mijë lekë.*
- *Subvencionimi i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti, për 4-mujorin e parë, janë alokuar 1,401,612 mijë lekë, për 11 bashki të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019. Deri në fund të muajit Prill, realizimi faktik i fondeve është në vlerën 851,511 mijë lekë.*

MBROJTJA

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi në përqindje për 4 mujorin e parë 2020 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 36: Mbrojtja

Në mijë lekë

Emërtimi i Programit

Plani 2020

Fakti 4 mujor

Përqindja e realizimit

	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,191,233	20,000	407,882	0	34.2%	0.0%
Forcat e Luftimit	5,628,093	2,231,264	1,309,418	88,454	23.3%	4.0%
Arsimi Ushtarak	5,753,167	241800	1,698,603	0	29.5%	0.0%
Mbështetja e Luftimit	595,570	110,000	165,794	0	27.8%	0.0%
Mbështetje për Shëndetësinë	1,279,224	618,686	285,755	3582	22.3%	0.6%
Emergjencat Civile	295,382	139250	26,390	0	8.9%	0.0%
Sigurimet Shoqerore per ushtaraket	5,122,136	0	1,663,000	0	32.5%	
Totali MM	19,864,805	3,361,000	5,556,842	92,036	28.0%	2.7%

Sipas të dhënave, realizimi faktik i shpenzimeve korente paraqitet pak nën mesataren e periudhës, si pasojë e procedurave në funksion të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19, po ashtu edhe investimet për të cilat u ndërpre procesi prokurimit, por pritet të kenë realizim në periudhën në vazhdim.

Për vitin 2020 objektivat kryesore në programin “**Planifikimi menaxhimi administrimi**” janë: Menaxhimi me efikasitet dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare. Treguesit e performancës për këtë objektivat:

- Rritja e % e punonjësve të trajnuar kundrejt totalit.
- Numër raportesh vlerësimi të kryera,
- Numër Aktesh ligjore e nënligjore të përgatitura kundrejt planifikimit
- Numër Auditimesh të kryera kundrejt planifikimit,
- Rritja e numrit të personave të rekrutuar.
- Rritja e numrit të Marrëveshjeve të realizuara kundrejt planifikimit.

Për këtë program buxhetor janë parashikuar 3 produkte si më poshtë:

- Akte ligjore e nënligjore të përgatitura nga Ministria e Mbrojtjes
- Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara
- Sisteme të mirëmbajtura për aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes

Këto produkte janë realizuar në vlerë në masën 407.428 mijë lekë ose 34 përqind të planit vjetor. Realizimi në këtë nivel është si rezultat i masave të marra anti Covid-19 dhe mosrealizimit të fondeve për disa projekte investimesh.

Fondet e akorduara për programin “**Forca e Luftimit**” përbëjnë rreth 34 përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2020. Programi Forcat e Luftimit ka parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Objektivat e këtij programi për vitin 2020 janë:

- Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Tokësore
- Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Detare
- Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve Operacionale të Forcës Ajrore

Treguesit e performancës për këto objektiva:

- Përgatitja e trupave për misione paqeruajtëse.
- Aftësia dislokuese e trupave për përmbushjen e misionit në një kohë rekord.
- Ndërveprueshmëria e trupave për përmbushjen e misioneve në det.
- Kontrolli i hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Fondet e akorduara për Programin “**Mbështetja e Luftimit**” përbëjnë rreth 25.9 përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes për 4-mujorin e parë të vitit 2020. Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike për realizimin e tyre, si:

- *Sigurimi i logjistikes së nevojshme si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare. Treguesit e performancës për këtë objektiv janë:*
 - ✓ Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e Forcave të Armatosura.
 - ✓ Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC dhe CIMIC.
 - ✓ Dokumente të procesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit në fuqi.
- *Sigurimi i inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet .Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 2:*
 - ✓ Përqindja e arritjes së përmbushjes së objektivave të kapaciteteve në fushën e inteligjencës ushtarake dhe të NATO-s.
 - ✓ Përqindja e arritjes së kapaciteteve të nevojshme operacionale.
- *Sigurimi dhe mbështesja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s. Treguesit e performancës për këtë objektiv Nr 3:*
 - ✓ Kapacitete operacionale për ASN
 - ✓ Ruajtja e nivelit operacional për Repartin nr. 6630
 - ✓ Janë planifikuar 29 Produkte, 13 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente “ dhe 16 Projekte Investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”.

Realizimi i fondeve buxhetore për 4-mujorin 2020 në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korente rezulton në masën 30 përqind, ndërkohë që investimet nuk kanë filluar ende realizimin.

Fondet e akorduara për Programin “**Arsimi Ushtarak**” përbëjnë rreth 3.1përqind të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për 4-mujorin e vitit 2020. Ky program synon “Rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet e NATO”.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- *Numër ushtarakësh të rinj të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve*
- *Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet.*
- *Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit.*
- *Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit.*
- *Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-ve.*
- *Numër personeli ushtarakë të gjinisë femra të pranuar në FA.*
- *Numër personeli i trajnuar/stërvitur.*

Realizimi i fondeve buxhetore sipas për 4-mujorin 2020 në këtë program buxhetor për grupin e shpenzimeve korente rezulton në masën 28 përqind.

Fondet e akorduara Mistrisë së Mbrojtjes për Programin “**Mbështetje për Shëndetësinë**” përbëjnë rreth 5.8 përqind të buxhetit me ndryshime, miratuar për MM në vitin 2020. Qëllimi i këtij

programi është 'Ofrimi i një Shërbimi sa më të Specializuar Mjekësor dhe Spitalor në nivel Universitar në trajtim në rang Kombëtar të politraumave". Treguesi i performancës për këtë qëllim:

- *Numri i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë dhe Terapisë*
- *Numri i Pacienteve të shtruar, të planifikuar dhe urgjente në SUT*
- *Numri i Operacioneve të sallës operatore të urgjencës*
- *Përqindja e vdekshmërisë.*

Objekti i parë për këtë program është "Pritja dhe trajtimi i pacienteve të poli traumatizuar në kohe reale pranë Urgjencës të SUT". Treguesi i performancës për këtë objektiv:

- *Nr. i Shtrimeve nga Urgjenca*
- *Nr. i Urgjencave të shërbimit të Kirurgjisë*
- *Nr. i operacioneve në Sallat Operatore të Urgjencës*
- *Nr. i manipulimeve të ndryshme kirurgjikale*
- *% e Mortalitetit në Urgjencë*

Objekti i II -të "Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacienteve të afuara nga specialitetet mjekësore pranë SUT". Treguesi i performancës për këtë objektiv:

- *Nr. i shtrimeve reanimatore*
- *Nr. i operacioneve sipas specialiteteve mjekësore në bllokun operator të SUT*
- *Nr. i Ekzaminimeve imazherike*
- *Nr. i Ekzaminimeve Laboratorike*
- *Ditë Qëndrimi në spital*
- *Koeficienti i shfrytëzimit të shtratit etj*

Për programin "Mbështetje për Shëndetësinë", realizimi i buxhetit total të programit kundrejt buxhetit të akorduar për vitin 2020 është në nivelin 22 %.

Fondet e miratuara për vitin 2020 për programin "**Emergjencat Civile**" përbëjnë rreth 1.4% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave:

- Sigurimi i logjistikes së nevojshme si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare. Treguesit e performancës për këtë objektiv NR 1.
 - ✓ % e Furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA.
 - ✓ Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC dhe CIMIC.
 - ✓ Dokumente të procesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit në fuqi.
- Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis. Tregues performance:
 - ✓ Jetë të shpëtuar
 - ✓ Familje të dëmshpërblyera
 - ✓ Infrastrukturë dhe mjedis i mbrojtur
- Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore. Tregues performance:
 - ✓ Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti, të cilat do të përdoren për t'i ardhur në ndihmë 4 000 familjeve të prekur nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore për një periudhë 1 mujore.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet e Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 37: Rendi dhe Siguria Publike

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4M 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Policia e Shtetit	15,221,229	670,951	4,422,217	64,648	29.05%	9.64%
	Financimi i huaj		818,868		237,970		29.06%
2.	Garda e Republikës	1,502,000	55,000	453,081	-	30.17%	0.00%
3.	Shërbimi i Gjendjes Civile	639,200	2,000	130,075	-	20.35%	0.00%
4.	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguar	484,900	45,000	138,580	45,000	28.58%	100%
	Financimi i huaj		-		11,629		

Në programin “Policia e Shtetit”, me realizimin e fondeve me rreth 28% ndaj planit vjetor, është realizuar qëllimi i politikës së programit. Qëllimi i këtij programi është: *“Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestëruar dhe goditur veprimtarinë e krimit të organizuar e rrjetet kriminale, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm. Përforcimi i zbatimit të ligjit për rritjen e nivelit të sigurisë publike dhe asaj rrugore. Menaxhimi efektiv, eficient dhe i integruar i kufijve nëpërmjet mirëfunksionimit të 27 pikave të kalimit kufitar në Republikën e Shqipërisë. Forcimi i kapaciteteve institucionale, garantimi i pavarësisë operacionale të policisë së shtetit dhe konsolidimi i arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit.”*

Qëllimi i programit realizohet nëpërmjet 4 objektivave dhe 25 produkteve të realizuar përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020, të cilat paraqiten si vijon:

Objekti 1 *“Rritja e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndër-institucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Realizimi i 41 *“Operacione të posaçme Konvencionale”* apo 75 % e sasisë së planifikuar, me një kosto totale prej 84 milionë lekë.
- Realizimi i 68 programeve për *“Mbështetjen për Strategjinë Anti-Kanabis, mbikqyrje ajrore”*, me një fond total prej 51 milionë lekë.
- Janë kryer 11,953 *“Operacione policore të hetuara dhe shërbime”*, apo 92% e sasisë së planifikuar për periudhën, me një kosto totale prej 2.5 milionë lekë.
- Janë realizuar 54 opracione në bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e narkotikeve. Janë realizuar 17,500 shkëmbime informacionesh me partnerët ndërkombëtar.
- Janë realizuar me 13% më shumë se një vit më parë nr i operacioneve të përbashkëta policore me EUROPOL-in.
- Janë sekuestruar 5% më shumë se një vit më parë asete nga veprimtaria kriminale.

Objektivi 2 *“Rritja e sigurisë Publike dhe Sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Realizimi i 1,960 *“Shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale”*, apo 86% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 80 milionë lekë.
- Janë realizuar 139 *“Shërbime të Forcave Speciale dhe e NSH për sigurimin e Rendit Publik”*, apo 89% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 311 milionë lekë.
- U realizuan 938 raste asistence dhe trajnime për Policinë e Shtetit, me kosto prej 58 milionë lekë.
- U punësuan 10% më shumë punonjëse të policisë rrugore gra ndaj totalit, krahasuar me një vit më parë.
- Janë realizuar 346 programe të policimit në komunitet faza e dytë (Qeverija Suedeze).

Objektivi 3 *“Forcimi i masave për luftën kundë krimin ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standarteve të sigurisë së kufijve sipas standarteve të BE-së dhe Kodit Schengen”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar 3 produkte përgjatë 4 mujorit, të cilët konsistojnë në :

- U realizuan 15 operacione të sigurisë në kufirin blu, apo 91% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 37 milionë lekë.
- Janë procesuar 10,151,000 persona në PKK, kategoria I; II dhe e II-të (ajrore, detare, tokësore), apo 97% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 612 milionë lekë.
- Janë trajnuar 50 Qen policie në kushte shërbimi.
- Janë realizuar 1,550 raste zbuluese të trafikimit të paligjshëm duke përdorur teknikat e posaçme hetimore.
- Janë trajtuar 320 shtetas të huaj në Qendrën e pritjes Karec

Objektivi 4 *“Përafrimi i standartve të shërbimeve policore me ato të BE-së ”*. Për realizimin e objektivit kanë kontribuar 5 produkte përgjatë 4 mujorit, të cilët konsistojnë në :

- U trajnuan 82 rekrut të rinj, apo 87% e sasisë së planifikuar për 4-mujorin, me një kosto totale prej 35 milionë lekë.
- U trajtuan 94 bashkëshorte të punonjësve të policisë së shtetit, në zbatim të VKM nr. 256, datë 25.03.2015 *“Për kompensimin e privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit”*

Programi “Garda e Republikës”, realizimi i fondeve me rreth 29% ndaj planit vjetor, ka realizuar qëllimi e politikës së programit. Qëllimi i këtij progami është: *“Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësishme të Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë, duke synuar arritjen e nivelit 100% të sigurisë.”*

Qëllimi i programit realizohet nëpërmjet objektivave specifike të parashikuara dhe 1 produkti të realizuar përgjatë 4-mujorit, me specifikisht i paraqitur si më poshtë:

- *Është realizuar ruajtja e 110 personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto prej 453 milionë lekë.*

Në programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, ka realizim të fondeve rreth 20 % ndaj planit vjetor, duke realizuar kështu edhe qëllimin e politikës së programit, e cila është : *“Konsolidimi i mëtejshëm të një sistemi të dixhitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe regjistrimi/përditësimi i të dhënave të shtetasve në Republikën e Shqipërisë me vërtetësi dhe në kohë reale.”* Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet produkteve sa më poshtë:

- Rregjistrimit të 296,420 akte dhe dokumente të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 129 milionë lekë.
- Nëpërmjet funksionit të sistemit të adresavë të përmirësuar dhe rritjen e funksionalitetit të RKGJC.

Programi “Prefektura dhe Funksonet e Deleguara”, ka realizuar fondet për 4 mujorin e parë të vitit 2020 në masën 37%. Qëllimi i politikës së programit është: *“Ndjekia e zbatimit të programit të Qeverisë në nivel vendor si përfaqësues i qeverisë”, i cili synohet të realizohet nëpërmjet objektivit: “Rritja e performacës së Prefektit të Qarkut në nivel vendor për zbatimin e reformës Administrativo-Territoriale”.* Për realizimin e objektivit kanë kontribuar produktet sa më poshtë:

- Janë kryer 287 monitorime në nivel qarku nga Perfekti i Qarkut me kosto prej 13 milionë lekë.
- Është dhënë ndihmë për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale, me kosto rreth 7 milionë lekë.
- Janë trajtuar 116 për administrimin dhe mbrojtjen e tokës.

KULTURA

Performanca e treguesve buxhetorë për programet e Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 38: Kultura

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4 mujori I 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikim, menaxhim administrim	160 400		40 537		25.2%	
2.	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	540 981	291 452	122 531	267	22.6%	0.09%
	Financimi i huaj		35 323				
3.	Arti dhe Kultura	762 000	579 500	209 525	252 643	27.4%	43.5%
	Financimi i huaj			145 000			

Në të dy programet ky realizim i planit të shpenzimeve korrente është i lidhur me mosplotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucioneve si edhe me procedurat e prokurimit të mallrave e shërbimeve, proces ky që zgjat deri në finalizimin e lidhjes së kontratës, por është parashikuar që realizimi i këtyre shpenzimeve në periudhat në vijim do të ndryshojë ndjeshëm.

Në programin **“Trashëgimia Kulturore”** është realizuar promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimisë dhe aktiviteteve në funksion të saj. Këto objektiva gjatë 4/Mujorit të parë të vitit 2020 janë arritur nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

- “Objekte monument kulture të ruajtura dhe të mbrojtura”, me një kosto faktike prej 71.7 milion lekë, ku:

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020, punimet kanë konsistuar kryesisht në mirëmbajtjen rutinë të objekteve të vizitueshëm , nxjerrjen e disaobjekteve nga gjendja e riskut, pastrime nga vegjetacioni si dhe në përgatitjen e objekteve të trashëgimisë kulturore për sezonin turistik. Gjatë periudhës janar-shkurt punimet janë zhvilluar me ritme normale , ndërsa në muajt mars prill punimet janë kryer me ritme me te ngadalta për shkak të pandemisë Covid-19. Gjatë kësaj periudhe kryesisht janë hartuar projektet e nevojshme për restaurimin e objekteve.
- “Muze të mirëmbajtura dhe të vizitueshëm nga publiku ” me një kosto faktike prej 45.9 milion lekë, ku:
 - Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, gjatë 4 mujorit të parë ka vijuar me aktivitete dhe promovime on-line të cilat kanë shënuar një rritje të aksesit të vizitorëve edhe në këtë mënyrë. Kryesisht është fokusuar në projektet e edukimit të cilat tashmë i ka të publikuara dhe lancuara në faqet zyrtare të këtij institucioni.
 - Muzeu Historik Kombëtar, gjatë këtij 4 mujori, ka realizuar veprimtarinë e vet kryesisht ne formatin online për shkak të mbylljes së muzeve për publikun. Janë kryer një sërë restaurimesh të objekteve pjesë të muzeut.
 - Muzeu kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik, Korçë, ka organizuar veprimtari qe janë lidhur me prritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë që administrohen nga këta muze.
 - Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat ka kryer një sërë veprimtarish me karakter promovues dhe njëkohësisht dhe mirëmbajtje të objekteve muzeore.
 - Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë gjatë 4 mujorit të parë ka kryer një sërë aktiviteteve në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore.
 - Muzeu Kombëtar “Gjethi” gjatë këtij 4 mujori është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore si dhe pritjen e vizitorëve si projektet “Kujtojmë për të mos harruar”, dhe “Mbresa” në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit.
 - Realizimi i punimeve restauruese të parqeve të Butrintit dhe Apolonisë.
- “Aktivitete, të fushës së trashëgimisë jomateriale”, me nje kosto faktike prej 2.6 mln lekë.
 - Projektet me thirrje për vitin 2020 të trashëgimisë jo materiale janë perzgjedhur 45 gjatë fazës së parë në shkurt 2020. Me shpalljen e pandemise nuk vazhduan procedurat e tjera për përzgjedhjen e fituesve.
 - “Trashëgimia materiale e jomateriale e inventarizuar”, me një kosto faktike prej 2.2 milion lekë. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2020 rezultojnë të regjistruara në bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore gjithsej 23 308 objekte nga të cilat 23 087 objekte në pronësi shtetërore dhe 221 objekte në pronësi private.

Programi **“Arti dhe Kultura”** ka qëllim edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike.

- “Investime të reja në skenat bashkëkohore”, përfshihen ndërtime e rikonstruksione në institucionet e artit dhe kulturës, ku përmendim “Rikonstruksionin e Teatrit të Operas dhe Baletit, që është në perfundim procesi.
- Veprimtari të realizuara në institucionet e art-kulturës nga të cilat përmendim:
 - ‘Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorik kombëtar’, 10 shfaqje me nje kosto faktike 86.6 milion lekë,
 - “Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror klasik dhe bashkekohor” , 10 shfaqje me nje kosto faktike 28.9 milion lekë.
 - “Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik teatror eksperimental klasik dhe bashkekohor “, 10 shfaqje me një kosto faktike 11.1 milion leke
 - “Aktivitete me fokus promovimin e krijimtarisë letrare”, e cila përfshin 5 aktivitete me nje kosto faktike 1.2 milion lekë.

POLITIKA E JASHTME

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimit dhe fuqizimit të diplomacisë ekonomike si dhe bashkërendimin e ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian. Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 39: Politika e Jashtme

Në mijë lekë

NR	Emërtimi i Programit	Plani 2020		Fakti 4 M 2020		Përqindja e realizimit	
		Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	142,800	2,000	41,539	2,626	29.1	131.3
2.	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,636,500	7,000	534,508	0	20.3	0.0
3.	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	252,500	-	50,202	-	19.9	-
4.	Mbështetje institucionale për procesin e Integritit	96,300	155,280	37,432	15,187	38.9	9.8
	TOTAL	3,128,100	164,280	663,681	17,813	21.2	10.8

Programi **“Mbështetje diplomatike jashtë vendit”**, synon:

- Nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit të gjithanshëm;
- Mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare e shtetërore dhe përkujdesin për interesat e qytetarëve shqiptarë në shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ku ato janë akredituar.

Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 534,508 mijë lekë. Në këtë program ndër produktet kryesore përmendim:

- ✓ “Mbështetja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese”, për 72 nga 356 punonjës të planifikuar.
- ✓ “Kuota ndërkombëtare” është kryer pagesa për 22 kuota nga 53 të planifikuara.

- ✓ “Familjarë të diplomatëve të trajtuar sipas ligjit”, për 27 nga 220 familjar personeli.

Programi “**Aktiviteti diplomatik dhe konsullor**” ka për qëllim:

zgjerimi, intensifikimi, diversifikimi dhe pasurimi i marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjik, vendet e Rajonit dhe Evropës dhe vende e tjera të botës, për të mbështetur mirëkuptimit dhe të respektit të ndërsjellët midis kombeve, respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit rajonal, dhe solidaritetit ndërkombëtar.

Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 50,202 mijë lekë, ku përmendim:

- ✓ Janë hartuar 7 nga 24 akte ligjore dhe nënligjore të planifikuara.
- ✓ Janë kryer 2 nga 15 vizita dhe takime lobimi për hapjen e negociatave;
- ✓ Janë zhvilluar 31 nga 305 vizita, takime dhe konsultime dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- ✓ Janë ofruar 2 nga 17 shërbimet konsullore.

Programi “**Mbështetje institucionale për procesin e Integritimit**” synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet bashkërendimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, menaxhimit të fondeve të BE-së, zhvillimit të negociatave të anëtarësimit të RSH në BE. Në përmbushje të synimit janë kryer disa aktivitete, me një kosto faktike 52,619 mijë lekë, ndër to përmendim:

- ✓ 2 takime të institucioneve të përbashkëta Shqipëri – Bashkimi Evropian ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
- ✓ U hartua dhe miratua VKM Nr.151 datë 19.02.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2020 – 2022”.
- ✓ Miratim i 3 paketave amenduese të Marrëveshjeve financiare ekzistuese IPA;
- ✓ Pjesëmarrje në një thirrje të hapur në kuadër të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF).

VI.3 Ecuria e detajuar e projekteve të investimeve publike, gjatë Janar-Maj 2020

Për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19, për një pjesë të madhe të kontratave të investimeve janë pezulluar punimet. Pritet që me normalizimin e situatës punimet të rifillojnë, dhe kontratat të realizohen kundrejt planit vjetor në gjysmën e dytë të vitit 2020. Pavarësisht kësaj, disa kontrata investimesh në disa ministri linje kanë përfunduar deri në gjysmën e parë të 2020, ku numri më i lartë i takon kontratave të MASR për arsimin bazë, arsimin e mesëm, laboratorë dhe zhvillimin e sportit.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Me fondet e alokuara për investime për vitin 2020, kanë përfunduar kontratat e mëposhtme:

Në programin “Transporti Rrugor”:

- Përmirësimi/rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior Loti 1 (vazhdimi), 168 mln lekë.
- Studim Projektim mbikalimi TEG, me vlerë 10.4 milionë lekë.

Në programin “Ujësjellës-Kanalizime”:

- *Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe stacioni i pompimit Lagja Potam, me vlerë 40.9 milionë lekë.*
- *Transformimi i stacionit të pompave Peqin, me vlerë 23.7 milionë lekë.*
- *Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura në zonën Dhrale-Palasë, Loti I, 138.3 mln lekë.*

- *Ujësjetësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Glladishtë dhe rrjeti i brendshëm i ujësjetësit Ersekë, me vlerë 428.3 milionë lekë.*
- *Sistemimi i furnizimit me ujë të zonës turistike Hamallaj, faza e I, Sukth.*
- *Ndërtim i ujësjetësit të fshatrave Lalëz, Bizë ,Daç dhe Shetë, Bashkia Durrës.*

Ministria e Arsimit dhe Sporteve

Për MASR deri në fund të muajit maj 2020 janë realizuar **12 kontrata investimesh**, për arsimin bazë, arsimin e mesëm, laboratorë dhe zhvillimin e sportit.

- Rikonstrukcion i plotë i pallatit të sportit "Arjan Arapi" Rrëshen, me vlerë 2.8 milionë lekë.
- Projekti "Jeto me sportin" "Rikualifikim i terreneve sportive në shkollat "Oso Kuka" B. Shkodër, "Ana e Malit", Oblikë dhe "At Gjon Kama" Gur i Zi", me vlerë 3.2 milionë lekë.
- Ambjente sportive + Rikonstrukcion i shkollës "Astrit Hyka" , fshati Kutalli, me vlerë 7 milionë lekë.
- Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare Velmisht, me vlerë 31.6 milionë lekë.
- Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare "Ajet Toska", Suk 2, me vlerë 1.2 milionë lekë.
- EKO Kampus Saranda, me vlerë 11.7 milionë lekë.
- Rikonstrukcion godine dhe ndertim palestere gjimnazi "Adem Vrapi", me vlerë 57.1 milionë lekë.
- Rikonstrukcion shtesë anësore e shkollës së mesme Haxhi Qehaj, Rrogozhinë, me vlerë 7.3 milionë lekë.
- Rikonstrukcion i shkollës "18 Tetori" Kucovë, me vlerë 29.9 milionë lekë.
- Rikonstrukcion+ndërtim palestër shkolla e mesme "Mustafa Kemal Atatürk" Pajove, me vlerë 14 milionë lekë.
- Rikonstrukcion i shkollës së mesme të përgjithshme, Këlcyrë, me vlerë 20.1 milionë lekë.
- Ngritja e një laboratorit të integruar në Fakultetin e Mjeksisë veterinare/UBT, në funksion të rritjes së sigurisë së produkteve ushqimore dhe përmirësimit të shëndetit të kafshëve, 17.9mln lekë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Me fondet e alokuara për investime për vitin 2020, kanë përfunduar objektet më poshtë:

- Furnizim vendosje pajisje kompiuterike, elektronike si dhe licencat për përdorimin e programeve të sistemit të integruar për Shërbimin e ri Kombëtar të Urgjencës, 1.9mln lekë.
- Ndërtim i qendrës së të moshuarve në Palasë, me vlerë 1.4 milionë lekë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Me fondet e alokuara për investime për vitin 2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë mbyllur 3 kontrata që i përkasin Arsimit të Mesëm Profesional:

- Shkolla Karl Gega, me vlerë 128.3 milionë lekë.
- Rikonstrukcion i Godinës së MFE dhe rrejtit LAN, me vlerë 146.9 milionë lekë.
- Rikostrukcion i Shkollës Hoteleri-Turizëm, 96.5mln lekë dhe shtesë kontrate 18.9mln lekë.

Ministria e Brendshme

Me fondet e alokuara për investime për vitin 2020, janë mbyllur 6 kontrata për kolaudim, supervizim, oponentë teknike dhe mjete transporti. Nga këto veçojmë:

- Blerje mjete transporti, me vlerë 253.9 milionë lekë.
- Pagesë oponente teknike për projektin Ndërtim i Korpusit të Policisë (selia e re e DPP&Akademia e Sigurisë), me vlerë 2.7 milionë lekë.

Ministria e Drejtësisë

- Pajisje të ndryshme për sistemin e burgjeve, me vlerë 409 milionë lekë
- Krijimi i sistemit Upgrade, me vlerë 80,400,000 lekë

Ministria e Mbrojtjes

- Sistemi i automatizimit të Burimeve të Mbrojtjes (j-6), me vlerë 18.2 milionë lekë.
- Blerje e pajisjes së pastrimit kimik për uniformat e ceremonialit të FA, për 6.2 milionë lekë.

Ne mbeshtetje te Reformes ne Drejtesi:

- Për vitin 2020 janë planifikuar 170 milionë lekë investime për përshtatjen e mjediseve të punës për SPAK e BKH, dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tyre (në buxhetin e Ministrisë së Brendshme).
- Për vitin 2020 janë planifikuar 17 milionë lekë investime për Këshillin e Lartë i Gjyqësor, për pajisje informatike, automjete dhe blerje sistem audio, video dhe përkthim simultan për nevoja të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Janë planifikuar 14 milionë lekë investime për Veprimtarinë e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në Sistemin e Drejtësisë, për blerje pajisje për ILD, KPK, KPA dhe Komisionerin Publik.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila DENAJ